





Црвен крст на Република Македонија
Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë
Macedonian Red Cross

ГОДИШЕН ИЗВЕШТАЈ
RAPORTI VJETOR
ANNUAL REPORT



2013



Kryqi i kuq i Maqedonisë është formuar më 17 mars të vitit 1945. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë është i njohur si shoqatë nacionale e Kryqit të kuq të Komitetit ndërkombëtar të Kryqit të kuq më 01.11.1995, ndërsa më 27 nëntor të vitit 1995 bëhet anëtar i plotë i Federatës ndërkombëtare të shoqatave nacionale të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, si anëtar i 169-të i Lëvizjes ndërkombëtare.

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë është organizatë e vetme në territorin e Republikës së Maqedonisë, të cilën e përbëjnë organizatat e Kryqit të kuq të komunave dhe qytetit të Shkupit. Kryqi i kuq i RM-së nuk paraqet shoqatë qytetarësh, por është organizatë vullnetare, masive, e pavarur, joqeveritare, jopartiake dhe humanitare e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Pozita dhe detyrat e Kryqit të kuq, përdorimi dhe mbrojtja e emblems dhe emri i Kryqit të kuq, si dhe mënyra e finansimit të detyrave të Kryqit të kuq janë të rregulluara në ligj të posaçëm Ligji për Kryqin e kuq të Republikës së Maqedonisë (gazeta zyrtare nr.41/94). Me Statutin e Kryqit të kuq të RM-së për së afërmi janë të rregulluara pozita dhe struktura e Organizatës si dhe qëllimet dhe detyrat themelore dhe i njëjti është në pajtueshmëri me Statutin e Federatës Ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe.

Si mundem të ndihmoj?

VIZIONI

I KRYQIT TË KUQ TË RM-së

PUNA JONË NË BAZË TË PARIMEVE UNIVER-SALE, KA FUQINË QË TA PËRPAROJË BOTËN KU JE-TOJMË NËPËRMJET PROMOVIMIT TË PAQES DHE TOLERANCËS, PREVENTIVËS EFIKASE, PËRGJIGJE NË KOHË DHE PËRKRAHJE ADEKUATE PËR POPULATËN E MJERUAR.

MISIONI

I KRYQIT TË KUQ TË RM-së

KRYQI I KUQ I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË ËSHTË ORGANIZATË HUMANITARE, VULLNETARE E CILA VEPRON NË PAJTUESHMËRI ME PARIMET THEMELORE TË LËVIZJES NDËRKOMBËTARE TË KRYQIT TË KUQ DHE GJYSMËHËNËS SË KUQE, DUKE PUNUAR NË PLANIN E SIGURIMIT TË NDIHMËS DHE SHËRBIMEVE PËR POPULLATËN E MJERUAR DHE PROMOVIMIN E TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE HU-MANITARE DHE VLERAVE HUMANE.

Vullnetarizoni

Vullnetarizimi është parim themelor i Lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe. Aktivitetet e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë janë të implementuara nga ana e 34 organizatave komunale të Kryqit të kuq (OKKK) dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit. Kyçuni edhe ju në familjen tonë.

Përmbajtja:



• HYRJA.....	46
• NDËRTIMI I SHOQATËSSË FORTË NACIONALE.....	47
• VEPRIM EFEKTIV NË KUADËR TË LËVIZJES NDËRKOMBËTARE TË KRYQIT TË KUQ DHE GJYSMËHËNËS SË KUQE.....	48
• VEPRIM EFEKTIV NË KUADËR TË LËVIZJES NDËRKOMBËTARE TË KRYQIT TË KUQ DHE GJYSMËHËNËS SË KUQE.....	51
• STANDARDE PËR BRENDIMIN E KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË.....	52
• BASHKËPUNIM PARTNEROR ME KORRIN DIPLOMATIK.....	52
• KONTRIBUT NDAJ BASHKËSIVË DHE VULLNETARIZIMIT.....	53
• MOBILIZIM TË FONDEVE	55
• AKTIVITETE RINORE	57
• TRANSPARENT PARA OPINIONIT.....	58
• IMPLEMENTIMI I QËLLIMEVE STRATEGJIKE TË STRATEGJISË 2020 TË KKRM-së.....	59
• QËLLIMI STRATEGJIK 1 – MBROJTJA E JETËS DHE TË MIRAVE TË NJERIUT DHE PËRFORCIMI I AKTIVITETEVE PËR PËRMIRËSIMIN NGA KATASTROFAT DHE GJENDJEVE NË KRIZË.....	59
• QËLLIMI STRATEGJIK 2 – PËRPARIMI I SHËNDETIT DHE JETËS SË SIGURT TË NJERËZVE.....	63
• QËLLIMI STRATEGJIK 3 – PËRPARIMI I KYÇJES SOCIALE DHE KULTURËS SË MOSDHUNËS DHE PAQES.....	70
• DISEMINIM	76
• MENAXHIM ME VULLNETARË.....	78
• FALËNDERIM PËR PARTNERËT DHE DONATORËT.....	79
• RAPORT FINANCIAR PËR VITIN 2013.....	80



HYRJE

Në vitin që shkoi orvatjet dhe kontributet tona vazhdimisht ishin të dedikuara për njerëzit të cilët kishin nevojë për kujdes dhe përkrahje. Shtatë mijë vullnetarë dhe 140 të punësuar në Kryqin e kuq të Republikës së Maqedonisë për çdo ditë dhanë kontribut maksimal që t'iu ndihmojnë kategorive të ndryshme të cilët kanë nevojë për shërbimet tona. Atë e kemi bërë nëpërmjet ngritjes së vetëdijes së popullatës për ndihmë dhe përkrahje në rast të katastrofave të ndryshme dhe gjendjeve alarmante, aktivitete për shpëtim në ujë dhe në mal, sigurim të ndihmës së parë, organizim të aksioneve për dhurimin e gjakut për të siguruar prodhime gjaku, kujdes shëndetësor preventiv, përkrahje sociale dhe edukim për kategoritë e mjeruara të popullatës, kujdes për personat e moshuar në kushte shtëpiake, bashkëpunim zhvillimor, aktivitete rinore, promovim të vullnetarizmit, sigurim të përkrahjes nga institucionet shëndetësore dhe sociale dhe aktivitete tjera të cilat u realizuan në republikë nëpërmjet 34 organizatave komunale të Kryqit të kuq dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit.

Ndikimi ynë i realizuar në bazë të numrit të personave të cilët i kemi përfshirë nga viti në vit është gjithnjë e më i madh. Me kënaqësi mund të themi se viti 2013 ishte më se i suksesshëm e për këtë shpresojmë se do të gjeni përgjigje në faqet e këtij raporti vjetor. Në punën tonë nuk kemi dalluar shumë nga kompanitë e suksesshme tradicionale. E kemi përcjellë rregullën ekonomike që ta zvogëlojmë inputin e ti rrisim rezultatet. Atë e kemi realizuar nëpërmjet përdorimit efikas të resurseve të kapshme me atë që qëllim nuk kishim të realizojmë përfitim por t'iu ndihmojmë sa më shumë njerëzve me nevoja më të ndryshme humanitare. Numrat dhe realizimet të cilat janë pas nesh na bëjnë krenar dhe na mburrin që të jemi edhe më të përgatitur dhe më të suksesshëm në vitet të cilat vijmë.

Aktivitetet tona ishin të drejtuara kah kënaqja e nevojave humanitare, dhe menaxhimi me sfida më të ndryshme por edhe në përgatitje dhe planifikim, përkrahje të bashkësive lokale në mbindërtimin e



kapaciteteve, sigurim të mundësive për popullatën e mjeruar që ta përmirësojë jetën e vet dhe orvatjet për ristrukturimin e brendshëm në punë. Ndërtuam raporte partnerore me institucionet qeveritare, organizatat ndërkombëtare, sektorin korporativ dhe Lëvizjen ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe që na mundësoi me sukses të ballafaqohemi me shumë sfida nëpërmjet implementimit të përbashkët të iniciativave e projektuesve dhe programore.

Mirënjohje dhe falënderim të posaçëm duam tu japim vullnetarëve tanë të cilët janë shpirti dhe forca lëvizëse e organizatës sonë, për kontributin e tyre, kohën dhe buzëqeshjet e tyre të cilat i dhurojnë gjatë realizimit të aktiviteteve të organizatës sonë. Respekt dhe falënderim të madh për partnerët dhe përkrahësit tanë të cilët mundësuan që planet tona të realizohen në vepra, kontributet tona të bëhen realitet që të kënaqen nevojat e përdoruesve tanë.

Falënderim deri tek të gjithë njerëzit të cilët ishin të përgatitur ta ndajnë kujdesin dhe vuajtjen e të tjerëve që të ulen vuajtjet e popullatës së rrezikuar. Në fund dëshirojmë t'iu falënderohemi të gjithëve të cilët iu mundësuan një mëngjes më të mirë njerëzve dhe iu dhanë mundësi për një jetë më dinjitoze.


D-r Millço Trajkov
Kryetar


M-r Sait Saiti
Sekretar gjeneral

NDËRTIM I NJË SHOQATE NACIONALE TË FORTË

Trajnim për procesin e planifikimit të projekteve dhe monitorim dhe evaluim. Në periudhën prej 24 – 26 janar të vitit 2013 Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë zbatoi trajnim për proces të planifikimit të projekteve/programeve dhe monitorim dhe evaluim që u mbajt në Strugë. Në këtë trajnim morën pjesë të punësuarit e qendrës së KCRM-së dhe KK të qytetit të Shkupit të cilët janë të obliguar për përpunimin e projekteve/programeve.

Trajnimi u zbatua sipas doracakëve të rinj të adaptuar të Federatës ndërkombëtare për planifikim të projekteve / programeve që më tej do të përdoren për zbatimin e trajnimeve në nivel lokal. Trajnimi në mënyrë primare ishte i drejtuar në menaxhimin e bazuar në bazë të rezultateve, ciklit projektues, vlerësimi, kornizës logjike, dhe aspekte të caktuara të monitorimit dhe evaluimit.

Takim pune me kryetarë të organizatave komunale të Kryqit të kuq dhe Organizatës qytetare të KK Shkup. Më 28 shtator u mbajt takim pune me kryetarë të organizatave komunale të Kryqit të kuq dhe Organizatës qytetare të KK Shkup në hapësirat e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë në Shkup. Qëllimi i takimit punës ishte evaluimi i punës nga viti i parë mandatar i strukturës udhëheqëse të organizatave komunale të Kryqit të kuq si dhe përmbajtje tjera lidhur me punën e shoqatës nacionale siç janë implikimet e akteve normative në punën e Kryqit të kuq, sfida në punën e udhëheqësve të OKKK, mësimet e mësuara dhe prioritetet për punë në vitin 2013.

Punëtori me sekretarë të OKKK dhe KK të qytetit të Shkupit. Në periudhën prej 03 deri më 05 tetor Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë mbajti takim pune me sekretarët e organizatave komunale të Kryqit të kuq që u organizua me përkrahjen e Komitetit ndërkombëtar të Kryqit të kuq në Strugë. Në këtë takim pune morën pjesë 30 sekretarë. Në punëtori Komiteti ndërkombëtar i Kryqit të kuq e prezantoi Kornizën për qasje më të sigurt të KNKK dedikuar për mbrojtjen e punës së personelit të Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe në rast të situatave në konflikte.

Punëtorja u përdor për prezantimin e më shumë përmbajtjeve lidhur me punën e shoqatës nacionale siç janë procesi i certifikimit, standardet për brendim, sfida dhe prioritetet në punën e OKKK, përgatitje të kornizës së re normative për punë në KCRM-së, zbatim të dispozitave strategjike të organizatës, zbatim të politikave të KCRM-së në nivel lokal, mobilizim të fondeve për përmirësimin e stabilitetit dhe pavarësisë financiare; punë projektuese dhe iniciativa për përparimin e aktiviteteve programore në nivel lokal, zbatim të sistemit efikas për monitorim dhe evaluim, përparim të sistemit për përgatitje dhe veprim gjatë

katastrofave dhe analizë të planeve strategjike sipas punës së Kryqit të kuq të RM-së.

Mbindërtimi i kapaciteteve të shërbimit profesional të Kryqit të kuq të RM-së. Në periudhën prej 22 deri më 24.11.2013 u realizua punëtori për mbindërtimin e kapaciteteve të resurseve njerëzore të qendrës së KCRM-së. Punëtorja u mbajt në Strugë në bashkëpunim me shtëpinë e konsultimit ITC Consulting. Qëllimi i trajnimit ishte të avancohen kompetencat e shërbimit në sferën e zhvillimit të organizatës efektive, zhvillim dhe udhëheqje të ekipeve efektive, menaxhim personal dhe ekipor, punë në ekipe, menaxhim me performanca dhe stres menaxhim.

Mbindërtimi i normativës së vazhdueshme dhe sjellje të dokumenteve të reja. Kuvendi i Kryqit të kuq të RM-së dhe Këshilli ekzekutiv si organ i tij ekzekutiv, në kuadër të kompetencave të veta e në pajtueshmëri me nevojat, sollën dokumente të rëndësishme të cilat e pasqyrojnë lidhshmërinë e pakëputshme të pjesës vullnetare dhe profesionale. Problemet lidhur me financimin e Organizatës sollën deri në iniciimin e procedurës për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për Kryqin e kuq të RM-së, zbatuar para organeve kompetente në Kryqin e kuq.

Ndihma e parë i aktivitetit i rëndësishëm programor e cila ballafaqohet me vështirësi në realizimin nga ana e organizatave komunale për shkak të ligjëratës jo adekuate nga ana e subjekteve tjera të pa autorizuar, dha shenjë që Kryqi i kuq i RM-së të iniciojë ndryshime dhe plotësime të Ligjit për siguri në komunikacionin rrugor, të përkrahur nga organet kompetente të shoqatës nacionale.

Standardet për rendimin e Kryqit të kuq të RM-së me vërtetimin e logos së Kryqit të kuq si dokument i ri mes tjerash tërhoqi ndryshime dhe plotësime në Statutin e Kryqit të kuq të RM-së. Procesi zgjedhor në Organizatë në vitin 2012 e futi nevojën për ndryshime dhe plotësime të Rregullave për procedurën zgjedhore dhe verifikimin e procesit zgjedhor.

Me Rregulloren për kritere për emërim dhe shkarkim të Sekretarit gjeneral të Kryqit të kuq të RM-së, e në të cilin janë implementuar dispozita edhe për Sekretarin e Organizatës komunale gjegjësisht Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit, rregullohet materia e cila del si obligim nga Statuti si akt më i lartë juridik i Organizatës.

VEPRIM EFEKTIV NË KUADËR TË LËVIZJES NDËRKOMBËTARE TË KRYQIT TË KUQ DHE GJYSMËHËNËS SË KUQE

Gjatë vitit 2013, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë realizoi një mori aktivitete në plan ndërkombëtar drejtuar kah sigurimi i mjeteve programore dhe projektuese për mbindërtim të kapaciteteve të veta, ndarje të përvojave dhe diturive pozitive dhe përparim të bashkëpunimit bilateral me shoqata nacionale të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe me organizata ndërkombëtare e agjenci tjera. Përfaqësues të KKRМ-së morën pjesë në më shumë konferenca ndërkombëtare, seminare, mbledhje, trajnime dhe kampe rinore. Aktivitetet ndërkombëtare janë pjesë integrale e këtij raporti.

Përparimi i bashkëpunimit bilateral mes Kryqit të kuq të Maqedonisë dhe Kryqit të kuq të Sllovenisë. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në kuadër të bashkëpunimit të realizuar me Kryqin e kuq të Sllovenisë, u vizitua nga ana e sekretarit gjeneral të Kryqit të kuq të Sllovenisë z. Danijell Starman së bashku me përfaqësues të shërbimit profesional. Vizita u mbajt prej 21 – 24.03.2013. delegacioni u pranua nga sekretari gjeneral i KKRМ-së m-r Sait Saiti dhe kryetari i KKRМ-së d-r Millço Trajkov. Gjatë vizitës përfaqësuesit e Kryqit të kuq të Sllovenisë e vizituan edhe Kryqin e kuq të qytetit të Shkupit, Qendrën ditore për persona të moshuar, Qendrën ditore për dhurimin e gjakut, Qendrën edukative për fëmijët e ikur – Shuto Orizarë dhe Pikën për të pastrehur në Momin Potok. Delegacioni i Kryqit të kuq të Sllovenisë gjithashtu realizoi vizitë edhe në organizatën komunale të KK Ohër. Gjatë vizitës u theksua përgatitja e dy shoqatave nacionale për përparim në bashkëpunimin bilateraë të shoqatave nacionale.

Pjesëmarrje në Forumin e delegatëve të Kryqit të kuq të Suedisë. Suzana Tuneva, sekretar i KK të qytetit të Shkupit mori pjesë në Forumin e delegatëve të KK të Suedisë që u mbajt në periudhën prej 3 – 8 maj të vitit 2013 në Stokholm, Suedi. Në këtë forum morën pjesë gjithsej 300 delegatë nga të gjitha zyrat rajonale të KK të Suedisë. Qëllimi i këtij Forumi ishte të bëhet evaluimi i punës dhe aktiviteteve të realizuara për përkrahjen e të ikurve, azil kërkuesve dhe të kthyerit në Maqedoni dhe të këmbëhen përvoja me shoqata tjera nacionale të cilat kanë praktika të mira nga fusha të caktuara. Në këtë forum morën pjesë 6 shoqata nacionale të cilat përpunuan tema të ndryshme programore të Lëvizjes.

Kuvendi zgjedhor i Kryqit të kuq të Bullgarisë. Në periudhën prej 17 – 18 maj të vitit 2013 delegacioni prej dy anëtarëve të Kryqit të kuq të RM-së

udhëhequr nga sekretari gjeneral m-r Sait Saiti mori pjesë në kuvendin zgjedhor të KK të Bullgarisë ku u rizgjodh për kryetar z. Hristo Grigorov si dhe trupa të rinj udhëheqës të KK të Bullgarisë për periudhën vijuese katër vjeçare. Delegacioni realizoi takim punues me kryetarin e Kryqit të kuq të Bullgarisë Hristo Grigorov duke u drejtuar në bashkëpunimin e deritanishëm dhe diskutoi për mundësitë për përparimin e bashkëpunimit në nivel programor dhe projektues në interes të të dy shoqatave nacionale dhe implementimi i programeve ku do të përdoren praktikatat e mira dhe përvojat pozitive të të dy organizatave, posaçërisht në fushën e sigurisë në ujë dhe siguri në male.

Evaluimi i programit për mbindërtim intensiv të kapaciteteve implementuar nga ana e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë në periudhën 2008 – 2011. Në periudhën prej 27 – 31.05.2013 Federata ndërkombëtare e KK dhe GJHK zbatoi evaluimin e implementimit të projektit trevjeçar për mbindërtim intensiv të kapaciteteve që u implementua në vendin tonë në periudhën prej vitit 2008 deri më 2011. Evaluimi i zbatua nga ana e Shon Hazeldin, përgjegjës për zhvillimin vullnetar. Evaluimi u zbatua nëpërmjet mësimin të raporteve të përgatitura gjatë implementimit të programit, takime me persona kyç në shoqatën nacionale të kyçur në implementimin e programit INK në Republikën e Maqedonisë dhe takime e intervista me përfaqësues të organizatave partnere (d-r Igor Gievski, anëtar i këshillit drejtues dhe m-r Iskra Tikvarovska nga njësia për komunikime të EVN Maqedoni dhe me z. Ibrahim Ibrahim – zëvendës ministër për punë dhe politikë sociale. U realizuan vizita të KK të qytetit të Shkupit dhe OKKK Prilep dhe Ohër.

Gjithashtu në Shkup u vizituan qendra ditore për dhurimin e gjakut dhe qendra ditore për persona të moshuar, pika për të pa strehur, qendra për

përkrahjen e kërkuesve të azilit dhe të ikurve, ambulanca e KK në Shuto Orizarë dhe stacioni malor i KK në Vodno si dhe qendra e porsahapur e KK për përkrahjen e të rinjve në Shuto Orizarë. Qëllimi i evaluimit ishte të matet përparimi i realizuar në tre fushat kyçe të programit për mbindërtim intensiv të kapaciteteve. Evaluimi me sukses u zbatua edhe mendimet janë të integruara në raportin e Federatës ndërkombëtare ku është vendosur pasqyrimi gjithëpërfshirës për punën e organizatës sonë.

Vizitë bilaterale e Kryqit të kuq të Austrisë.

Në periudhën prej 05 – 07 qershor në vizitë të KKRMSë ishte delegacioni i KK të Austrisë i udhëhequr nga sekretari gjeneral z. Werner Kershbaum. Qëllimi kryesor i vizitës ishte që të këmbëhen përvojat dhe të diskutohen rezultatet e arritura nga projekti kujdesi për personat e moshuar financiar nga ana e Agjencisë australiane për zhvillim dhe nga ana e KK të Austrisë të implementuar në periudhën qershor 2011 – shtator 2013. Në kuadër të vizitës u vizituan KK i qytetit të Shkupit, OKKK Kriva Pallankë dhe Veles ku implementohen aktivitetet në kuadër të projektit Kujdes për personat e moshuar në kushte shtëpiake. Përfaqësuesit nga Austria patën mundësinë që në mënyrë të drejtpërdrejtë të njihen dhe të bisedojnë me anëtarët e ekipeve projektuese, t'i vizitojnë dhe t'i dëgjojnë mendimet dhe përshtypjet e tyre nga realizimi i këtij projekti.

Bashkëpunim me Kryqin e kuq të Gjermanisë – Organizata krahinore Baden Vitenberg. Në kuadër të shënimit të 50 vjetorit të tërmetit katastrofal në Shkup në periudhën prej 24 – 28 Korrik, në vizitë zyrtare të KK qëndroi delegacioni i Kryqit të

kuq të Gjermanisë nga Baden Vitemberg udhëhequr nga sekretari gjeneral Hans Hajnc. Këta persona në mënyrë të drejtpërdrejtë ishin të kyçur në aktivitetet për ndihmë dhe përkrahje të personave të moshuar në tërmetin katastrofal në Shkup të vitit 1963, që gjatë vizitës së tyre i përcollën aktivitetet lidhur me kujtimet e ngjarjes së 26 korrikut. Në kuadër të vizitës u realizua takim me kryetarin e qytetit të Shkupit, gjithashtu u vizituan KK i qytetit të Shkupit, organizatat komunale të KK Kriva Pallankë dhe Ohër, si dhe qendra ditore për fëmijë me nevoja të posaçme në Dibër.

Vizita e drejtorit të zyrës së KK/BE nga Brukseli.

Në periudhën prej 01 deri më 03 shtator Kryqi i kuq i RM-së u vizitua nga z. Leon Prop – drejtor i zyrës së KK/BE në Bruksel. Gjatë vizitës dyditore u organizuan takime me shërbimin profesional që të paraqiten mundësi të caktuara për bashkëpunim dhe përkrahje të cilat i ofron zyra e KK/BE në Bruksel në bazë të aplikimit të projekteve të ndryshme në Bashkimin evropian. Z. Leon Prop e paraqiti qëndrimin organizativ të zyrës së KK/BE, mënyrën e financimit dhe vendimit në këtë zyrë, strukturën dhe pajisjet kadrovike dhe mundësitë për përkrahje të shoqatave nacionale, para se gjithash për ata të cilët janë vende anëtare të Bashkimit evropian por edhe për Maqedoninë si vend me status kandidat për anëtar në Bashkimin evropian. U vizituan edhe Kryqi i kuq në Kumanovë dhe KK i qytetit të Shkupit.

Bashkëpunim multilateral i shoqatave nacionale nga rajoni. Në periudhën prej 11 – 14/10.2013 kryetari i KKRMSë mori pjesë në mbledhjen tradicionale pune të përfaqësuesve të shoqat-



ave nazionale të KK të rajonit që u mbajt në Debeli Rtiç – Slloveni. Në këtë mbledhje morën pjesë përfaqësues të shoqatave nazionale të KK të Kroacisë, Serbisë, Malit të Zi, Bosnjës dhe Hercegovinës, Sllovenisë dhe Maqedonisë. Në këto sesione u këmbënyen informacione për aktivitetet e secilës shoqatë nazionale gjatë vitit të kaluar në bazë të sfidave dhe arritjeve të ndryshme.

Shënimi i 135 vjetorit nga formimi i Kryqit të kuq të Kroacisë. Në periudhën prej 21 – 23 dhjetor të vitit 2013 një delegacion prej dy anëtarëve të KKRМ-së udhëhequr nga sekretari gjeneral m-r Sait Saiti mori pjesë në shënimin e 135 vjetorit të formimit të KK të Kroacisë dhe 20 vjetori i pranimit në Federatën ndërkombëtare. Manifestimi qendror u mbajt në Zadër më 22 tetor në Teatrin nacional Kroat. Delegacioni i KKRМ-së gjithashtu mori pjesë edhe në manifestimin e organizuar në Zagreb më 23 tetor nga ana e KK të Zagrebit me rastin e 60 vjetorit të fillimit të aktiviteteve për dhurimin e gjakut në Kroaci. Gjatë qëndrimit u realizua edhe takim pune në Qendrën e KK të Kroacisë.

Shënimi i 150 vjetorit të formimit të Kryqit të kuq të Gjermanisë. Në kuadër të shënimin të 150 vjetorit të aksionit humanitar të Kryqit të kuq të Gjermanisë, një delegacion i KKRМ-së udhëhequr nga sekretari gjeneral m-r Sait Saiti mori pjesë në këtë ngjarje të rëndësishme të organizuar në Shtutgart në periudhën prej 28.10 – 01.11.2013. Gjatë qëndrimit delegacioni u njoftua me aktivitete të caktuara të KK Baden Vitemberg në pjesën e aktiviteteve sociale – humanitare. Ngjarja qendrore u realizua në Hallën e kongreseve në Shtutgart ku morën pjesë përfaqësues të të gjitha krahinave të KK të Gjermanisë, si dhe mysafirë nga KK i Austrisë, Zvicrës, Belgjikës dhe përfaqësues të Komitetit ndërkombëtar të KK të Gjenevës.

Mbledhje statutare të Lëvizjes. Në periudhën prej 9 deri 19 nëntor të vitit 2013 në Sidnej – Australi u mbajtën 19 mbledhjet statutare të Lëvizjes ku mori pjesë kryetari i KKRМ-së, d-r Millço Trajkov. Prej 12 deri më 15 nëntor u mbajt Kuvendi gjeneral i Federatës ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, ndërsa prej 16 deri më 18 nëntor u mbajt Këshilli i Delegatëve të Lëvizjes. Konferenca globale e të rinjve të KK dhe GJHK u mbajt në periudhën prej 09 deri më 11 nëntor të vitit 2013. Mes këtyre dy mbledhjeve statutare u mbajtën edhe dy ngjarje – Forumi humanitar më 11 nëntor dhe Fshati humanitar në periudhën prej 11 deri më 18 nëntor. Në kuvendin gjeneral të Federatës ndërkombëtare u diskutua për ardhmërinë e lëvizjes dhe implementimin e Strategjisë 2020. U mbajtën edhe më shumë punëtori ku u diskutua për më shumë tërësi tematike me interes për shoqatat

nacionale. Për kryetar të Federatës ndërkombëtare u rizgjodh Tadateru Konoe i Kryqit të kuq të Japonisë.

Këshilli i delegatëve u mbajt në Sidnej më 17 dhe 18 nëntor dhe në të u shqyrtuan më shumë çështje me interes për Lëvizjen ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe. Gjatë mbledhjeve statutare kryetari i KKRМ-së, d-r Millço Trajkov realizoi takime bilaterale me përfaqësues të më shumë shoqatave nazionale të KK dhe GJHK dhe përfaqësues të Lëvizjes.



DISPOZITA ZHVILLIMORE PËR PËRPARIMIN E KAPACITETEVE TË SHOQATËS NACIONALE

Certifikimi i punës së shoqatave nacionale të Kryqit të kuq / Gjysmëhënës së kuqe. Si rezultat i arritjeve në periudhën e kaluar në fushën e zhvillimit organizativ dhe mbindërtimit të kapaciteteve, Sasho Taleski, udhëheqësi i sektorit për programe të KCRM-së ishte pjesë e ekipit prej dy personave të Federatës ndërkombëtare i cili e facilitoi procesin e certifikimit të Gjysmëhënës së Katarit në periudhën prej 14 – 16 janar të vitit 2013. Pjesëmarrja e përfaqësuesit tonë në sigurimin e përkrahjes së orvatjeve globale të federatës ndërkombëtare për sigurimin e përkrahjes zhvillimore të shoqatave nacionale paraqet mirënjohje për arritjet e shoqatës tonë në planin e mbindërtimit të kapaciteteve dhe zhvillimit organizativ në periudhën e kaluar.

Mbledhje për certifikimin e shoqatave të forta nacionale. Në periudhën prej 17 deri më 18 shtator të vitit 2013, Sasho Taleski, udhëheqësi i sektorit për programe mori pjesë në mbledhjen për certifikimin e shoqatave nacionale nga Evropa që u

mbajt në organizim të Federatës ndërkombëtare të KK/GJHK – Zona rajonale Budapest. Në mbledhjen morën pjesë 15 shoqata nacionale nga Evropa si dhe ekipi për zbatimin e procesit të certifikimit nga Budapesti dhe Gjeneva. Qëllimi i mbledhjes ishte të prezantohen gjendjet më të reja në bazë të zbatimit të procesit të certifikimit në botë si dhe lajmërimi për aktivitete vijuese të këtij plani. Deri tani procesi i certifikimit kanë kaluar 48 shoqata nacionale të KK / GJHK.

Mbledhje për zhvillim organizativ të Federatës ndërkombëtare. Në periudhën prej 08 deri më 12 tetor të vitit 2013, Sasho Taleski, udhëheqës i sektorit për programe mori pjesë në mbledhjen për zhvillim organizativ dhe certifikim që u mbajt në organizim të Federatës ndërkombëtare të KK/GJHK – Sekretariat. Në këtë mbledhje morën pjesë përfaqësues të 4 Zonave të Federatës ndërkombëtare përgjegjës për zhvillim organizativ dhe udhëheqësit e sektoreve të Federatës ndërkombëtare të Sekretariatit në Gjenevë. Mbledhja punuese u mbajt në Gjenevë, Zvicër. Në mbledhje u diskutua Korniza për zhvillimin e shoqatave nacionale të Federatës ndërkombëtare e cila i përmban dokumentet më të reja gjithëpërfshirëse të cilat duhet të dihen nga ana e strukturave udhëheqëse dhe drejtuese të shoqatave nacionale dhe të cilat duhet të jenë ciceron në punën e përditshme për komponentet e Lëvizjes ndërkombëtare të KK dhe GJHK. Gjithashtu u diskutua procesi i certifikimit për shoqata të forta nacionale me çka është paraqitur faza e dytë e certifikimit të KCRM-së që do të zbatohet në fillimin e vitit 2014.



STANDARDE PËR BRENDIMIN E KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Shoqata nacionale kah fundi i vitit 2013 përgatiti Standarde për brendimin e KKRM-së. Standardet për brendim të shoqatës nacionale kanë rolin e rregullave të shkruara për formë, madhësi, kualitet, kontroll dhe mënyrë të barabartë të përcjelljes së zbatimit të logos së KKRM-së. Zbatimi i unifikuar i standardeve për rendimin nga ana e të gjitha subjekteve në organizatë do të kontribuojë kah bashkimi funksional, dizajni i unifikuar, dhe njohja në vend, por edhe më gjërë.



BASHKËPUNIM PARTNEROR ME KORRIN DIPLOMATIK

Vizita e ambasadorit të Rumanisë në Kryqit të kuq Republikës së Maqedonisë. Më 21 nëntor të vitit 2013 Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë, z. Iustinian FOCSA. Sekretari gjeneral m-r Sait Saiti e njoftoi ambasadorin me punën e KKRM-së në vend dhe në plan ndërkombëtar si dhe me bashkëpunimin e frytshëm të cilin e ka organizata jonë me KK e Rumanisë në periudhën e kaluar, posaçërisht në pjesën e bashkëpunimit bilateral që u realizua në pajtueshmëri me marrëveshjen e nënshkruar për bashkëpunim mes dy shoqatave nacionale. Posaçërisht u theksua bashkëpunimi në nivel lokal të cilin e realizojnë tre organizata komunale të KKRM-së (Tetovë, Krushevë dhe Shkup) dhe tre organizata komunale të KK të Rumanisë (Ploeshti, Gjurgju dhe Sektori 3 – Bukuresh). Ambasadori theksoi se do të japë kontributin e vet në avancimin e bashkëpunimit mes dy organi-

zatave posaçërisht në pjesën e sigurimit të përkrahjes për iniciativa rajonale projektuese të cilat realizohen nëpërmjet Bashkimit evropian dhe fondeve tjera, duke pasur parasysh se vitin që vjen Rumania e ndërmerr kryesimin me Bashkimin evropian.

Vazhdimi i Marrëveshjes për bashkëpunim me Ambasadën e Francës në Republikën e Maqedonisë. Më 25.11.2013 në hapësirat e KKRM-së, sekretari gjeneral m-r Sait Saiti dhe Ambasadori i Francës në Republikën e Maqedonisë zonja Lorens Oer e nënshkruan marrëveshjen e re për bashkëpunim me kohëzgjatje prej tre vjetëve. Sekretari gjeneral u falënderua për bashkëpunimin e deritanishëm të frytshëm me ambasadën e Francës që u realizua me shoqatën tonë. Në këtë takim u paraqitën aktivitetet programore të Kryqit të kuq të RM-së të cilat paraqesin iniciativa për vazhdimin e bashkëpunimit

dhe përkrahjen e aktiviteteve nga ndihma e parë, përgjigje dhe veprim në rast të katastrofave, projekte sociale – humanitare në bashkëpunim me sektorin qytetar në RM-së, si dhe koordinim me ekipet e përbashkëta të cilat janë të përbëra nga persona të Bashkësisë franceze në RM-së dhe anëtarë të ekipit për përgjigje gjatë katastrofave të KCRM-së. Ambasadorja Lorens Oer theksoi kënaqësinë e bashkëpunimit të deritanishëm, si dhe interesin e ambasadës franceze në përparimin e mëtutjeshëm të bashkëpunimit të përbashkët dhe përkrahjes së qëllimeve humanitare të KCRM-së.



KONTRIBUTI KAH BASHKËSITË DHE VULLNETARIZIMI

Dita ndërkombëtare e vullnetarizmit. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë dhe Ministria për punë dhe politikë sociale e shënuan Ditën botërore të vullnetarizmit 5 dhjetori me organizim të manifestimit solemn që u mbajt në hapësirat e Muzeut të Luftës së Maqedonisë ku u ndanë shpërblime, u theksua aktiviteti vullnetar dhe u dëgjua zëri i vullnetarëve nëpërmjet fjalimeve dhe deklaratave vullnetare për përfitimet e tyre dhe për rezultatet e arritura. Në këtë manifestim fjalim mbajtën edhe persona publik si shembuj pozitiv të cilët e praktikojnë dhe përkrahin vullnetarizmin dhe u ndanë shpërblime vullnetare për arritje të posaçme dhe atë në: Klubin e të rinjve të KK Veles për aktivitetin e treguar për të ndihmuar grupet më të ndryshme qëllimore, të KK Ohër për mobilizimin e një numri të madh të vullnetarëve, të vullnetarëve të Klubit të personave të moshuar të KK Kriva Pallankë për proaktivitetin e vet dhe qëndrueshmërinë e klubit, si dhe Ljupço Millkovskit dhe Xvonko Sekullovskit për merita të posaçme në realizimin e qëllimeve dhe detyrave të shoqatës nacionale dhe për aktivitetin e vet prej më shumë se tridhjetë vjet si vullnetar.

Si vazhdim i aktiviteteve të programit “Kryqi i kuq në Aksion – Promovimi i Vlerave Humane” u nda edhe OSKAR për filmin më të mirë të përpunuar nga ana e vullnetarëve në kuadër të “Javës së promovimit të vlerave humane” nëpërmjet të cilit promovohet rëndësia e aktivitetit vullnetar, bashkëpunimi ndëretnik dhe kulturor i dialogut. Gjatë

ngjarjes, vullnetarët i ndanë çek prej 165 000 denarëve Entit për ndëshkim – Burgu Ohër, nga mjetet e grumbulluara nga ana e vullnetarëve në kuadër të “Javës së promovimit të vlerave humane”. Në këtë manifestim mbajti fjalim kryetari i KCRM-së z. Millço Trajkov i cili theksoi se nuk ekziston vlerë më e madhe se sa dhënia e diturisë personale, aftësive, kohës apo resurseve për dikë që ka nevojë për ndihmë.

Ministria e punës dhe politikës sociale në kuadër të këtij manifestimi për herë të dytë i ndau shpërblimet nacionale për vullnetarizëm. Alen Osman, vullnetar aktiv në KCRM-së është zgjedhur për vullnetar të vitit. Për organizator të punës vullnetare është shpërblyer Komuna e Velesit, nga mediumet është shpërblyer TV SITEL, ndërsa shpërblimin për praktikë vullnetare e mori asociacioni i të rinjve IMK – Manastir. Ministri i punës dhe politikës sociale z. Dime Spasov në kuadër të fjalimit të vet theksoi se vullnetarët krijojnë vlerë që nuk përshkruhet për shkak se posedojnë njohuri dhe aftësi të dobishme për bashkësinë. Secilin vullnetar e stolis kualiteti i pasuruar me dimensionin human të vullnetit të mirë, përderisa shtetet synojnë kah zhvillimi i vullnetarizmit.

8 maji – Dita botërore e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe. Në vitin 2013 u shënuar 150 vjetori i formimit të Lëvizjes dhe 150 vjetori i aksionit humanitar të KK dhe GJHK, në nivel lokal dhe global. Me këtë rast u promovua triska e re postare e botuar në bashkëpunim me SHA Postat e Maqedonisë me temë “150 vite aksion humanitar”. Në këtë solemnitet mbajti fjalim kryetari i KCRM Millço Trajkov i cili e theksoi rëndësinë e aktivitetit vullnetar, bashkimin e të gjitha komponentëve të Lëvizjes dhe sukseset për të ndihmuar popullatën e mjeruar në 150 vitet e kaluara aksion humanitar dhe poashtu fjalim kishte edhe prof. d-r Vlladimir Ortakovski i cili e theksoi rëndësinë dhe aksionin humanitar të Komitetit ndërkombëtar të KK nëpër historinë dhe aktivitetin e KCRM-së kah promovimi i të Drejtës ndërkombëtare humanitare.

Në kuadër të aktiviteteve të realizuara për shënimin e 8 majit u ndanë falënderime për mbi 100 dhurues të gjakut në mbështetjen e Ministrisë të shëndetësisë të RM-së z. Nikolla Todorov dhe u organizuan tubime publike në më shumë organizata komunale. U organizuan aksione për grumbullim dhe ndihmë të grupeve të ndryshme qëllimore, debate në OKKK për rëndësinë e Lëvizjes dhe të drejtës ndërkombëtare humanitare, dhe u organizuan ngjarje mediale publike. Gjithashtu, Kryqi i kuq ishte pjesë e Garës së njohur të Shkupit ku vullnetarët morën pjesë në mënyrë aktive në ndihmën dhe përkrahjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e ndihmës së parë.



MOBILIZIMI I FONDEVE

Bashkëpunim me sektorin korporativ. Bashkëpunimi me sektorin korporativ dhe zbatimi i partneriteteve strategjike me kompanitë është një ndër burimet më kryesore për sigurimin e resurseve për përkrahjen e aktiviteteve projektuese dhe programore të Kryqit të kuq. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në vitin 2013 realizoi bashkëpunim me disa kompani të rëndësishme të cilat e praktikojnë punën shoqërore të përgjegjshme dhe të njëjtat siguruan përkrahje në aktivitetet projektuese dhe programore për të ndihmuar grupet e mjeruara qëllimore dhe popullatën në vend. Gjatë vitit 2013 u realizua bashkëpunim me gjithsej 17 kompani të cilat siguruan përkrahje në aktivitetet projektuese dhe programore të KKRМ-së në vlerë të përgjithshme prej 4.990.700 denarëve që paraqet kontribut të rëndësishëm në realizimin e qëllimeve humanitare të organizatës.

KOMPANI	Bashkëpunim i realizuar dhe përkrahje të aktiviteteve
EVN MAQEDONI SHA	-Përkrahje në Projektin Zhvillim i përbashkët i bashkësisë në bashkësinë e mjeruar rromë në Shuto Orizarë – Qendra ditore për përkrahjen e të rinjve -Përkrahje në shënimin e Javës së kujdesit për personat e moshuar – gjilpëra të siguruar dhe lenta për matje pa pagesë të sheqerit në gjak për 2000 persona të moshuar, botim të materialit promovues (postere dhe broshura) -Përkrahje të Projektit kujdes për personat e moshuar në kushte shtëpiake i cili implementohet nëpërmjet Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit dhe OKKK Veles, Kriva Pallankë, Kërçovë dhe Dibër, me të cilin janë përfshirë gjithsej 180 persona të moshuar. -Është implementuar aksioni i përbashkët humanitar “Të ndajmë lumturi” – janë ndarë pako për vitin e ri për 700 fëmijë me nevoja të posaçme dhe fëmijë të familjeve të rrezikuara sociale.
BANKA KOMERCIALE SHA Shkup	-Përkrahje në projektin për përmirësimin e socializimit të fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të posaçme (340 fëmijë) implementuar nëpërmjet 7 organizatave komunalë të KK dhe KK të qytetit të Shkupit.
ALFA BANKA SHA Shkup	-Janë siguruar 6 kontenjerë për donacion të veshmbathjeve dhe 15 kasa për donacionin e mjeteve financiare të vendosura në qytetin e Shkupit. -Janë siguruar bluza për dhurues të gjakut (100).
POSTA E MAQEDONISË	-Përkrahje në fushatën e Ditës së urisë – Aksion I dedikuar për ndihmë të popullatës së mjeruar – dergimi I flaerave falas deri me 13000 kompani në Maqedoni.
BIRRARIA SHA SHKUP	-Donacion të 7.560 litra ujë dedikuar për të ndihmuar popullatën e pësuar nga vërshimet.
VEZË SHARRI	-Përkrahje e Pikës për të pa strehuarit – ushqim nga prodhimet e kompanisë gjatë vitit. -Donacion të prodhimeve të veta për përkrahjen e garës për ndihmë të parë të KKRМ-së.
EKO SHARR, VIVAKS, PROMES, MAGRONI, ZHITO POLLOG DHE KIM	-Donacion të prodhimeve të veta për përkrahjen e Garës shtetërore nga ndihma e parë e KKRМ-së.
STOBI	-Donacion të prodhimeve të veta.
PANAIRI I SHKUPIT	-Është siguruar përkrahje për hapësirë në organizimin e ngjarjeve të KKRМ-së.
Fondacioni T-MOBILE për Maqedoni	-Është siguruar numër pa pagesë për donacione
ONE	-Është siguruar numër pa pagesë për donacione
VIP	-Është siguruar numër pa pagesë për donacione

Mbindërtimi i kapaciteteve. Në organizim të zyrës së Maqedonisë të projektit TAKSO më 29 dhe 30 prill të vitit 2013 në Strumicë u mbajt punëtori me temë “Bashkëpunim dhe grumbullim të mjeteve nga biznes sektori” ku morën pjesë 25 përfaqësues të shoqatave qytetare dhe fondacioneve. Në këtë punëtori me përfaqësues të vet mori pjesë edhe KKRМ-së. Qëllimi i punëtorisë ishte të mbindërtohen dituritë dhe aftësitë e personave të cilët janë të angazhuar për grumbullimin e mjeteve nga burimet lokale, si dhe të ndahen përvoja. Dituria e hasur në punëtori do të drejtohet kah zhvillimi i mëtejshëm i programit për mobilizimin e resurseve të KKRМ-së.

Mbledhje partnerore. Më 14 maj të vitit 2013 në Panairin e Shkupit, u mbajt mbledhja e katërt partnerore në organizim të Kryqit të kuq të RM-së me qëllim që të promovohen vlerat humane dhe kapacitetet e KKRМ-së për nxitjen e partneriteteve strategjike për implementimin e programeve të përbashkëta sociale të dobishme shoqërore për përmirësimin e kualitetit të jetës së popullatës së mjeruar. Në këtë manifestim mori pjesë Ministri i ekonomisë z. Valon Saraçini, Ambasadori i Ambasadës së Sllovenisë në RM-së z. Branko Rakovec, përfaqësues i Ambasadës amerikane në RM-së, përfaqësues i Odës ekonomike të RM-së, si dhe përfaqësues të sektorit korporativ. Katalogu i përgatitur i projekteve së bashku me materiale të publikuara të KKRМ-së iu ndanë përfaqësuesve të pranishëm në Mbledhjen partnerore me qëllim që të nxitet interesi i partnerëve për veprim të përbashkët dhe zbatim të partneriteteve strategjike në sfera të caktuara me interes reciprok. Në këtë mbledhje u paraqitën praktikatat pozitive nga bashkëpunimi i deritanishëm partneror i suksesshëm i KK dhe kompanive EVN Maqedoni, Banka Komerciale SHA Shkup dhe Sigurimi SAVA.

Politika për mobilizimin e fondeve të Kryqit të kuq të RM-së. Politika e sjellur për mobilizimin e fondeve të Kryqit të kuq të RM-së paraqet bazë të qasjes sistemore në mobilizimin e resurseve, me të cilin janë definuar drejtimet dhe format për sigurimin e resurseve. Në bazë të Politikës do të krijohen aktivitete për mobilizimin e resurseve në baza të ndryshme dhe nga më shumë burime (Fonde BE, fonde ndërkombëtare, institucione qeveritare, sektori korporativ, individë etj), me qëllim që të sigurohen mjete adekuate për implementimin e programeve dhe projekteve për përkrahjen e grupeve të mjeruara qëllimore të popullatës. Njëkohësisht ky dokument paraqet bazë të për-



gatitjes së Strategjisë së re për mobilizimin e fondeve të KCRM-së.

Politika për ndarjen e mirënjohjeve të Kryqit të kuq të RM-së për kompanitë. Bashkëpunimi partneror me kompanitë është një ndër qëllimet strategjike të KCRM-së për mobilizimin e fondeve të sektorit korporativ. Ndarja e mirënjohjeve për kompanitë është komponentë e rëndësishme për përfundimin e partneriteteve me sektorin korporativ për përmirësimin e stabilitetit financiar të shoqatës nacionale për implementim të suksesshëm të programeve të KK. Me qëllim që të vërtetohet lloji, kushtet dhe mënyra e ndarjes së mirënjohjeve për kompanitë, Kryqi i kuq i RM-së solli Politikë për ndarjen e mirënjohjeve, dokument në bazë të së cilit ishin ndarë mirënjohje adekuate për disa kompani me të cilat KK realizon bashkëpunim të frytshëm.

Mirënjohje të ndara të Kryqit të kuq të RM-së. Më 12 dhjetor të vitit 2013 KCRM-së organizoi manifestim për ndarjen e mirënjohjeve të Kryqit të kuq "Medalja e artë" dhe "Përkrahësi bronzë". Qëllimi i këtij manifestimi të rëndësishëm ishte që tu ndahen mirënjohje partnerëve, përkrahësve të misionit humanitar të KCRM-së të cilët siguruan përkrahje adekuate në implementimin e programeve të përbashkëta sociale të dobishme shoqërore për përmirësimin e kualitetit të jetës së popullatës së mjeruar në vend. Mirënjohja "Medalja e artë" iu nda z. Zhivko Mukaetov drejtor gjeneral në SHA Alkaloid Shkup, ndërsa mirënjohja "Përkrahësi bronzë" iu nda kompanive Alfa banka SHA Shkup, Telekom i Maqedonisë SHA Shkup, Birraria SHA Shkup dhe Sigurimi SAVA SHA Shkup në shenjë falënderimi për realizimin e qëllimeve dhe detyrave humanitare të Kryqit të kuq. Këto kompani si partnerë të rëndësishëm të KK në vazhdimësi sigurojnë përkrahje të programeve shoqërore sociale të KCRM-së për përmirësimin e kualitetit të jetës së popullatës së mjeruar në bashkësi.

AKTIVITETE RINORE

Klube të të rinjve. Në pajtueshmëri me planin strategjik të të rinjve të KCRM-së 2011 – 2015 si dhe nevoja për zhvillim të vazhdueshëm të klubeve të të rinjve, përfundimi i kapaciteteve të tyre për tërheqjen e popullatës së mjeruar, në vitin 2013 u realizuan më shumë iniciativa nacionale dhe lokale për krijimin e "Klubeve të të rinjve të cilat funksionojnë mirë". Në Kryqin e kuq të RM-së funksionojnë gjithsej 35 klube të të rinjve.

Kampi veror i të rinjve. Në periudhën prej 22 – 29 korrik të vitit 2013 u organizua trajnim nacional për

menaxhim me vullnetarët e rinj në kuadër të kampit veror për të rinj tanimë tradicional "100% Kryq i kuq". Në hapësirat e Universitetit FON në Strugë me angazhim të trajnuesve me përvojë në kuadër të punës rinore, 66 pjesëmarrës prej 26 Klubeve kishin mundësi të hasin dituri dhe aftësi të reja për veprim më efikas dhe më efektiv të klubeve të të rinjve në drejtim të plotësimit të përcaktimeve strategjike të organizatës.

Analiza e gjendjeve të klubeve të të rinjve.

Si pasojë e aktiviteteve për mbindërtimin e kapaciteteve tek rinia në dy vitet e kaluara dhe sjellja e risive në komunikim dhe mbajtje të transparencës, është përmirësuar aftësia e vet vullnetarëve për vetëvlerësim dhe analizë të punës vijuese të klubeve me çka janë përcaktuar edhe prioritetet dhe fusha të reja për zhvillim. Pas vërtetimit të sfidave të caktuara në punën e një numri të caktuar të klubeve të të rinjve nga ana e Këshillit të të rinjve të Kryqit të kuq të RM-së, është zbatuar "Analiza e gjendjeve të klubeve të të rinjve për vitin 2013" e cila është e plotësuar me planin operativ për vitin 2014 për përmirësim. Ky proces mundëson zhvillim të mëtutjeshëm të klubeve të të rinjve, por gjithashtu edhe të tërë shoqatës nacionale duke marrë parasysh pozitën e të rinjve të cilët e kanë në të.

Radio emisioni "Kryqi i kuq qosh". Në punën e të rinjve është futur edhe një risi në mbajtjen e transparencës në punën dhe promovimin e aktiviteteve të Kryqit të kuq nëpërmjet krijimit të radio emisionit "Kryqi i kuq qosh" i cili një herë në javë rregullisht emitohej në internet radion "Radio MOF" e cila është një ndër radio stacionet më të njohura posaçërisht tek rinia – studentët.

Këshilli nacional rinor. Viti 2013 për rininë në Republikën e Maqedonisë ishte jashtëzakonisht i rëndësishëm për shkak të themelimit të Këshillit nacional rinor të Maqedonisë, i cili paraqet organizatë ombrellë e cila i përfaqëson të rinjtë para institucioneve për çështjet me interes të tyre, ndërsa njëkohësisht paraqet edhe platformë për veprimtari të përbashkët dhe krijim të partneriteteve të organizatave joqeveritare të cilat punojnë për edhe me të rinj. Kryqi i kuq i RM-së është një ndër gjithsej 56 organizata të cilat e përkrahën themelimin e tij dhe në mënyrë aktive merr pjesë në punën me status të "Lidhja e organizatave të të rinjve" si rrjet prej 35 klubeve të të rinjve.

TRANSPARENT PËR OPINIONIT

Informimi dhe marrëdhëniet me opinionin ishin pjesë integrale e orvatjeve të përgjithshme të organizatës drejtuar kah përparimi i transparencës dhe llogaridhënies dhe përmirësimi i imazhit të shoqatës nacionale.



Internet faqja e KCRM-së dhe OKKK. Redizajnimi dhe mbindërtimi i internet faqes së KCRM-së mundësoi hapësirë për shpalljen e një numri të madh të informacioneve të llojllojshme, struktura e së cilës ka për qëllim kategori të ndryshme të vizitorëve. Pasurimi i tillë i ueb faqes me përmbajtje interaktive kontribuoi për vizitë më të madhe të qytetarëve të RM-së dhe më gjerë.

E-gazeta. Botimet javore të gazetës elektronike të Kryqit të kuq, tanimë në mënyrë tradicionale paraqesin shembull të mjetit të suksesshëm për informimin e vullnetarëve tanë, partnerëve, bashkëpunëtorëve dhe përkrahësve për aktivitetet të cilat i realizojmë në nivel lokal, nacional dhe ndërkombëtar. Në vitin 2013 u përgatitën 69 numra të gazetës elektronike të KCRM-së me 591 tekste të botuara. Gazeta dërgohej deri tek pothuajse 70.000 adresa elektronike dhe i njëjti rregullisht azhurohej dhe shpallej në internet faqen e KCRM-së me çka opinioni në vend dhe më

gjerë kishte mundësi që për së afërmi të njihet me aktivitetet e organizatës.

Publikime. Javët tradicionale të definuara në ligjin për Kryqin e kuq, si dhe një numër i madh i aktiviteteve projektuese dhe dokumenteve strategjike në kuadër të veprimtarisë botuese të Shoqatës nacionale edhe këtë vit rregullisht ishin plotësuar me materiale kreative, atraktive dhe edukative në formë të broshurave, pamfleteve, doracakëve, triskave me pagesë shtesë dhe lloj tjetër botimi. Duke i bartur me vete porositë humanitare apo drejtimet për veprim, u arritën rezultate të rëndësishme tek grupet qëllimore, e njëkohësisht edhe në mënyrë pozitive ndikohej në ngritjen e imazhit të shoqatës nacionale. Me qëllim që të gjitha publikimet të jenë më afër tek personat për të cilët janë dedikuar, edhe këtë vit KCRM-së të gjitha botimet e veta i botoi në gjuhën maqedonishte dhe në gjuhën shqipe, e një pjesë e tyre ishin të përkthyer edhe në gjuhën angleze.

QËLLIMI STRATEGJIK 1

MBROJTJA E JETËS DHE MIRËQENIEVE TË NJERIUT DHE PËRFORCIMI I AKTIVITETEVE PËR RIMËKËMBJE NGA KATASTROFAT DHE GJENDJET NË KRIZË

Menaxhimi me katastrofa, në KCRM-së është fushë specifike dhe e segmentuar, baza vepruese e së cilës gjithnjë bazohet në ekzistimin e mjeteve materiale teknike, resurseve njerëzore dhe vlerësimet e mjerueshmërisë në rast të katastrofave, prej të cilave më tej dalin të gjitha planet aksionare, trajnimet specifike të vullnetarëve, përgatitja e dokumenteve, e gjithë kjo sjell që Kryqi i kuq të njihet si organizatë profesionale e cila së bashku me institucionet shtetërore e përbën sistemin për menaxhim me kriza.

PËRGATITJE DHE VEPRIM GJATË KATASTROFAVE DHE GJENDJEVE NË KRIZË



Programi për përgatitje dhe veprim gjatë katastrofave në vitin 2013 vazhdimisht i ka implementuar qëllimet strategjike të Planit strategjik për përgatitje dhe veprim gjatë katastrofave 2012 – 2016. Për këtë qëllim, u mbajtën më shumë punëtori për përgatitje dhe veprim gjatë katastrofave në OKKK Qendër, Gazi Babë dhe Demir Hisar, si dhe në Qendrën ditore për persona të moshuar pranë KK të qytetit të Shkupit.

Vullnetarët e KCRM-së morën pjesë në më shumë trajnime dhe simulime. Në bashkëpunim me Drejtorinë për mbrojtje dhe shpëtim dhe Njësinë territoriale zjarrfikëse të qytetit të Shkupit me sukses realizuan evakuimin e personelit dhe pacientëve në Spitalin klinik "Axhibadem Sistina".

KCRM-së mori pjesë në trajnimin "Rezistencë e bashkuar 2013" (Shared Resilience 2013) që u mbajt në muajin qershor në qendrën ushtarake për trajnim "Pepelishte" – Krivollak në organizim të Ministrisë për mbrojtje. Në trajnimin ndërkombëtar, përkaj ARM-së, morën pjesë edhe ekipe të armatave prej 15 vendeve tjera, shërbime civile, DMSH, IMP dhe KCRM-së. Kryqi i kuq mori pjesë me ekipe të veta mjekësore për shpëtim, si dhe me ekip për shërbimin për kërkim.

Bashkëpunimi intensiv dhe i vazhdueshëm me Akademinë ushtarake "Gjenral Mihajlo Apostol-ski" vazhdoi edhe gjatë qershorit të vitit 2013 me pjesëmarrje të Kampusit ndërkombëtar veror 2013. U prezantua roli i Kryqit të kuq në operacione post – konflikte, nëpërmjet simulimeve praktike dhe skenarëve me aktivitete ushtarake – humanitare. Vullnetarët e Kryqit të kuq morën pjesë edhe në trajnimin final tregues – taktik "Forca multinacionale në para-

qitjen e operacioneve për përkrahje dhe stabilizim” ku vullnetarët patën sukses të kontraktajnë ndaljen e zjarrit mes palëve të acaruara dhe të distribuojnë ndihmë humanitare dhe të bëjnë evakuimin e një pjese të popullatës civile”.

Projekti “Aktivitete për uljen e rreziqeve nga katastrofat”. Gjatë vitit, u implementua projekti “Aktivitete për uljen e rreziqeve nga katastrofat” me përkrahje financiare nga ana e Gjysmëhënës së Turqisë. Projekti u implementua në mikro rajonet Vallandovë dhe Qendra Zhupë. Aktivitete projektuese përbëheshin nga përgatitja e vlerësimeve nga rreziqet e mundshme në rajonet e selektuara, e pastaj dhe seleksionimi i shkollave fillore dhe të mesme të cilat do të përfshihen me projektin. Në seleksionimin e shkollave u realizua vlerësim i mjerueshmërisë dhe në bazë të të njëjtës u përgatitën elaborate dhe plane teknike për evakuim të shkollave në rast të katastrofave. Në bazë të dokumenteve të lartpërmendura, u bënë modifikime infrastrukturore në shkolla, ku u montua sinjali i panikut dhe plane për evakuim, si dhe kuti për ndihmë të parë. Ekipi projektues në mënyrë plotësuese realizoi edhe punëtori për mbrojtje dhe vetëmbrojtje në rast të katastrofave, ndihma e parë për organizata punuese, prezantoi metodologjinë për promovimin e higjienës dhe i paraqiti planet për evakuim, gjegjësisht se si të përdoren.

RIMËKËMBJE NGË KATASTROFAT DHE KRIZAT

Menaxhim me pasojat e vërshimeve – 2013.

Rreshjet e vazhdueshme të cilat e përfshinë RM-së kah fundi i muajit shkurt, nxitën vërshime të numërta në disa rajone në Maqedoni. Rajonet më të përfshira nga vërshimet ishin Kumanova, Shtipi (Novo Sellë), Sh. Nikolla (Sh. Nikolla, Gorubinci, Mustafino, Erxhelija), Strumica (komuna Vasilevë – Sushevë – Strumica e epërme, Murtino, Saçevo, Dabilja, Prosenikovo, Dobrejce, Banica, komuna Bosilevë – Monospitovë, komuna Novo Sellë, Zubovë), Vallandovë (Josifovo) dhe Probishtipi (Pishica, Bunesh, Draç dhe tripatanci). Sasia e madhe e ujit nxiti edhe dëmtimin serioz të tendave Mavrovica (Sh. Nikollë), Sllatinska (f. Sllatinë), Pishica (Probishtip).

Përskaj tendave të dëmtuara, vërshimet nxitën edhe dëmtime serioze infrastrukturore që prapë se prapë nuk nxiti problem të posaçëm gjatë distribuimit të ndihmës humanitare, për shkak se për shumicën e fshatarve ekzistonin rrugë alternative. Në mënyrë plotësuese në muajin prill, rreshjet e reja të shiut nxitën vërshime në Ohër dhe Manastir.

Kryqi i kuq i RM-së nëpërmjet organizatave komunale të KK realizuan vlerësim në teren dhe në bazë të të njëjtës u distribuua ndihma humanitare drejtpërsëdrejti tek përdoruesit. Qendra plotësuese operative pranë KKRMsë analizoi vlerësimet e marrura nga ana e institucioneve shtetërore, gjegjësisht Qendra për menaxhim me kriza dhe Ministria për punë dhe politikë sociale. Nëpërmjet aksionit të shpejtë dhe në kohë të KKRMsë, së pari nga rezervat e veta, e pastaj edhe nga fondi urgjent për menaxhim me katastrofa, me sukses u plotësuan nevojat humanitare të popullatës dhe në mënyrë të rëndësishme u ndihmua procesi i rimëkëmbjes.

Nga ana e fondit urgjent për menaxhim me katastrofa të Federatës ndërkombëtare Kryqit të kuq të RM-së iu ndanë gjithsej 176,424 CHF për menaxhim me pasojat nga vërshimet të cilat e përfshinë shtetin kah fundi i muajit shkurt. Kryqi i kuq i RM-së me sukses e realizoi operacionin dhe me planin e paraparë për aksion pati sukses t’i kënaqë nevojat humanitare për familjet e goditura nga vërshimet rajonale.

Mësime të mësuara. Gjatë periudhës prej 10 – 11 maj të vitit 2013, në pushimorën në Dojran të Vjetër të Kryqit të kuq të RM-së, u mbajt punëtori për mësime të mësuara dhe evaluim të operacionit të realizuar për të ndihmuar popullatën e goditur nga vërshimet në vitin 2013 dhe trajnim elementar për vlerësim të kapaciteteve dhe për informim financiar.

Në punëtori morën pjesë 25 persona të OKKK të cilat u gjendën në rajonet e vërshuara dhe atë: Kumanovë, Sh. Nikollë, Shtip, Probishtip, Strumicë dhe Vallandovë, si dhe vullnetarë të ekipit për përgjigje gjatë katastrofave të KK të qytetit të Shkupit, të cilët gjatë tërë kohës ishin të kyçur në mënyrë aktive në të gjitha aktivitetet e ndërmarra.

Suksesi i operacionit, mund të vërtetohet edhe nëpërmjet studimit të zbatuar për vërtetimin e nivelit të kënaqësisë së përdoruesve nga ndihma e fituar humanitare. Studimi u realizua në bashkëpunim me Federatën ndërkombëtare – Zyrën evropiane në Budapest, dhe e njëjta është e këtij lloji në vend dhe rajon, e në të ishin të kyçur vullnetarë të OKKK që nuk janë pjesë e operacionit për shkak të sigurimit të objektivitetit më të lartë. Rezultatet e mara, të cilat në numër të madh ishin pozitive kah Kryqi i kuq dhe aktivitetet e ndërmarra, do të përdoren për përmirësim të ardhshëm të performansave në punën e organizatës gjatë menaxhimit me katastrofa.

SISTEMI YNË PËR MENAXHIM TË KATASTROFAVE

Sistemi për menaxhim me katastrofa, bazohet në bashkëpunimin me institucionet shtetërore dhe me aktivitetet e veta siguron përkrahje apo i plotëson aktivitetet e ndërmarra nga qeveritarët. Për këtë qëllim në vitin 2013 në bazë të rregullt u mbajtën mbledhje koordinuese me përfaqësues të Qendrës për menaxhim me kriza dhe drejtorinë për mbrojtje dhe shpëtim.

Në kuadër të përmirësimit dhe përforsimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, Kryqi i kuq në mënyrë aktive mori pjesë në trajnimin simulues “SMER JIE – koordinim dhe përgjigje” në organizim të Qendrës për menaxhim me kriza.

Kryqi i kuq i RM-së në bashkëpunim me institucionet tjera qeveritare dha kontribut të posaçëm në përpunimin e “Strategjisë për uljen e rreziqeve nga katastrofat” të Qendrës për menaxhim me kriza.

Kryqi i kuq i RM-së nëpërmjet përfaqësuesve të vet në Komitetin nacional për ndryshime klimatike, nëpërmjet një mori punëtorish mori pjesë gjatë përpunimit të Planit të tretë nacional për ndryshime klimatike i cili përpunohet në kuadër të Ministrisë për ambient jetësor dhe planifikim hapësinor.



FORUMI PËR ADAPTIM NË NDRYSHIMET KLIMATIKE

Kryqi i kuq i RM-së gjatë vitit me sukses e implementoi projektin Forum i Evropës Juglindore për adaptim në ndryshimet klimatike. Si pjesë e aktiviteteve finale të projektit, ekipi rajonal u përkushtua në qëndrueshmërinë e të njëjtit dhe për këtë qëllim u realizuan një mori aktivitete. Mbledhjet ishin të përcjella nga përfaqësues të KK të Maqedonisë, Austrisë, Kroacisë, Malit të Zi dhe përfaqësues të sektorit joqeveritar të Serbisë. Takimet rezultuan me iniciativa për inkorporimin e dy shteteve plotësuese në kuadër të Forumit (Shqipëria dhe Bosnja e Hercegovina) me të cilët gjatë vitit është arritur marrëveshje, si dhe krijim të qasjes së re strukturale në pikëpamje të funksionimit të rrjetit.

Përkaj aktiviteteve rajonale, në nivel nacional u mbajt mbledhje pune të Rrjetit nacional për përgjigje klimatike, ku morën pjesë përfaqësuesit e sektorit joqeveritar dhe institucioneve qeveritare. Përkaj pajtueshmërisë së përbashkët të arritur në bazë të aktiviteteve të ardhshme të rrjetit nacional, e me atë edhe të Forumit rajonal, mbledhja kishte edhe karakter edukativ ku u prezantuan broshura për Sistem klimatik, klimë dhe ndryshime klimatike.

Me qëllim promovimin më të suksesshëm të aktiviteteve në fushën e adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike, vullnetarë të KK dhe një pjesë e organizatave joqeveritare të cilët janë pjesë e rrjetit, morën pjesë në festivalin "Alarm për natyrën 2013" që u mbajt në muajin gusht në Dojran. Në këtë manifestim, Rrjeti kishte paraqitjen e vet, ku para të pranishmëve të shumtë të përfaqësuesve të organizatave dhe institucioneve të ndryshme, si dhe vet vizitorët e festivalit i promovoi aktivitetet e veta.

Kah fundi i vitit të kaluar, Forumi i Evropës Juglindore për adaptim në ndryshimet klimatike, u inkorporua në Strategjinë 2020 të Evropës Juglindore - Vende pune dhe prosperitet në perspektivën evropiane. Me këtë roli i Forumit është i njohur në nivel rajonal.

SIGURI NË UJË

Në planin e sigurisë në ujë gjatë vitit të aluar u mbajtën tre kurse për edukim të shpëtuesve në ujë në ujëra të hapura dhe të mbyllura dhe u trajnuan gjithsej 90 persona.

Në mënyrë plotësuese sikur edhe çdo vit Qendra për siguri në ujë Ohër, që është pjesë e OKKK Ohër kishte angazhuar 45 shpëtues të cilët kujdeseshin për

sigurinë e notuesve në bregun e Ohrit, Prespës dhe Dojranit. Në kuadër të aktiviteteve të veta, Qendra për siguri në ujë Shkup, angazhoi rreth 30 shpëtues në ujë në Akua parkun në Shkup dhe në pishinat tjera.

SHËRBIMI PËR KËRKIM

Përfaqësues i KKRМ-së mori pjesë në Takimin e 6-të rajonal të Shërbimeve për kërkim të shoqatave nacionale nga rajoni në Beograd. Në këtë mbledhje u përpunuan përbajtje të cilat janë në pajtueshmëri me qëllimet e Strategjisë për realizimin e lidhjeve familjare të Lëvizjes 2008 – 2018. KKRМ-së për herë të parë mori pjesë me përfaqësues të vet, në Mbledhjen vjetore për realizimin e lidhjeve familjare, me shoqatat nacionale shtetet e së cilave janë anëtare të BE, Kryqi i kuq i Amerikës, KK i Kanadasë, KK i Australisë dhe Gjysmëhëna e kuqe e Turqisë, në Lisabon, Portugal. Në mbledhje u këmbyen përvoja dhe u soll qëndrim i përbashkët në lidhje me çështjen e migrimeve, që në dekadën e fundit janë problem i madh në Lëvizjen e KK dhe GJHK, posaçërisht kur bëhet fjalë për realizim të sërishëm të lidhjeve të ndërprera familjare.

Sipas të dhënave statistike të Shërbimit për kërkim të Kryqit të kuq të RM-së, gjatë vitit të kaluar janë filuar 5 raste të personave të zhdukur, prej të cilëve 4 kanë të bëjnë me persona të zhdukur nga vendi ynë dhe një rast i migrimit nga Somalia në RM-së, me çka Shërbimi për kërkim i KKRМ-së në bashkëpunim me shërbimin e KK të Zvicrës me sukses e zgjodhën dhe e mbyllën këtë rast.



QËLLIMI STRATEGJIK 2

PËRPARIMI I SHËNDETIT DHE JETA E SIGURT TEK NJERËZIT

Kryqi i kuq i RM-së në pajtueshmëri me Strategjinë 2020 dhe aktivitetet e rregullta programore në vitin e kaluar implementoi aktivitete në terren me qëllim që të mundësojë promovimin e shëndetit si parakusht më i rëndësishëm për realizim të plotë të potencialit njerëzor, dinjitetin njerëzor dhe të drejtat e njeriut. Gjithashtu në kuadër të punës së vet, në këtë periudhë u implementuan disa projekte për grupe të mjeruara të qytetarëve, t'i përforcojnë kapacitetet e të njëjtave por edhe ta promovojnë preventivën si faktor më të rëndësishëm për mbrojtjen e shëndetit personal.

Ulja e dëmeve nga përdorimi i drogave. Ulja e dëmeve nga përdorimi i drogave është projekt i dedikuar për personat – përdorues të drogave dhe zhvillohej në territorin e tre OKKK Kërçovë, Veles dhe Prilep. Qendrat e hapura në këto OKKK kishin për qëllim të ofrojnë shërbime mjekësore, sociale dhe juridike për përdoruesit si dhe t'i furnizojnë të njëjtit me prezervativë, pajisje sterile për injektim dhe material edukativ informativ.

Qëllimi i projektit është ulja e dëmeve nga përdorimi i drogave, në drejtim të përmirësimit të statusit shëndetësor, social dhe ekonomik të përdoruesve. Përdoruesit e drogave kishin mundësi të fitojnë pajisje sterile për injektim si dhe këshilla për dëmet e mundshme të nxitura nga përdorimi i pajisjeve jo sterile siç janë HIV/SIDA dhe hepatiti B dhe C. Në bashkëpunim me Institutin për shëndet publik dhe OJQ HERA u realizua edhe këshillimi në terren i besueshëm dhe tes-

tim në Prilep dhe Veles.

Nëpërmjet realizimit të punësive kreative që kanë për qëllim risocializimin e klientëve, të njëjtit kishin mundësi ta shprehin talentin e tyre nëpërmjet vizatimit, përpunimit të stolive dhe gjërave të ndryshme prej gline, letre etj. Me projektin gjatë vitit 2013 u përfshinë 274 persona nga popullata përdoruese. Janë realizuar 2178 shërbime sociale, 3489 shërbime mjekësore, 280 shërbime juridike, 123 shërbime psikologjike dhe 32 këshillime të besueshme dhe teste.

Kujdesi për persona të moshuar në kushte shtëpiake. Qëllimi i projektit është që të kontribuohet për përmirësimin e kushteve për jetën e personave të moshuar e të mjeruar dhe përforsimi i sistemit shëndetësor dhe social i personave të moshuar në Republikën e Maqedonisë. Projekti u implementua në tre qytete dhe atë në Shkup, Kriva Pallankë dhe Veles.



Në çdo qytet u përfshinë 60 persona të moshuar më të vjetër se 65 vjet, të cilët jetojnë vet. Për të njëjtit bazë e rregullt u ishte sigurimi i shërbimeve shëndetësore dhe sociale nga ana e ekipeve lokale të përbëra nga motra medicinale dhe vullnetarë.

Gjatë muajit shtator në Strugë si aktivitet përfundimtar të këtij projekti u realizua Punëtorja nacionale ku morën pjesë përfaqësues të institucioneve shtetërore, qendrat për punë sociale, përfaqësues të grupit qëllimor, ekipet lokale, Fakulteti për punë sociale, përfaqësues të KK të Kroacisë dhe Austrisë dhe Ministria e punës dhe politikës sociale. Gjithashtu pjesëmarrësit kishin mundësi të njihen me përvojat e vendeve tjera si Kroacia dhe Austria dhe modelet e tyre për kujdes për personat e moshuar në kushte shtëpiake. Me përkrahje financiare nga kompania EVN projekti vazhdon të funksionojë edhe në vitin 2014, me zgjerim edhe në dy komuna Kërçovë dhe Dibër.

Përpunimi i planeve strategjike dhe operative të vetëqeverisjes lokale. Gjatë vitit 2013 projekti u implementua në OKKK Kriva Pallankë. Qëllimi i projektit u krijua në plan lokal strategjik operativ për kontrollimin e tuberkulozit në nivel lokal me të cilin do të kontribuohet për përmirësimin e kontrollit të tuberkulozit edhe në orvatjet nacionale për kontrollimin e kësaj sëmundjeje. Projekti u realizua duke përdorur metodologjinë e Zhvillimit të përbashkët të bashkësive të Federatës ndërkombëtare të KK dhe GJHK qëllimi i së cilit ishte të vërtetohen problemet në bashkësitë dhe nevojat prioritare në bazë të tuberkulozit në nivel lokal dhe informacionet e nevojshme në bazë të aktiviteteve të cilat duhet të hyjnë në kuadër të planit operativ. Në muajin shtator, plani lokal aksionar u miratua nga ana e Komunës Kriva Pallankë.

Zbatimi i edukimeve për tuberkulozë për grupe të ndryshme qëllimore. Me qëllim ngritjen e vetëdijes publike tek popullata për preventivë nga tuberkuloza si sëmundje ngjitëse dhe mënyrat e mundshme të bartjes dhe mbrojtjes, mundësitë për shërim etj. KKRm-së gjatë vitit 2013 realizoi edukime për popullatën rome, popullatën në mjediset rurale, popullatën rome, popullatën etnike etj. nëpërmjet këtyre edukimeve për ngritjen e vetëdijes dhe preventivës së tuberkulozit u përfshinë gjithsej 2.796 përfaqësues të pakicave etnike dhe grupeve qëllimore dhe u realizua trajnim për 15 edukatorë për tuberkulozë.

Shëndeti seksual dhe reprodaktiv në kushte krize. Gjatë muajit maj përfaqësues i KKRm-së mori pjesë në trajnimin për koordinator për shëndet seksual dhe reprodaktiv në kushte krize në organizim të UNFPA. Qëllimi ishte të hasen njohuri dhe aftësi për realizimin e minimum standardeve për shëndet reprodaktiv dhe seksual në kushte krize.

Pjesëmarrje në zgjedhjen e përfaqësuesve të sektorit qytetar në Mekanizmin nacional koordi-

nativ të RM-së. Në këshillin e anëtarëve të rinj të sektorit qytetar në Mekanizmin nacional koordinativ që u mbajt gjatë muajit tetor, pas prezantimit të kapaciteteve të KKRm-së e cila si edhe periudhën e kaluar, ashtu edhe në të ardhmen do të japë kontributin e vet dhe do të angazhohet për funksionim më të mirë të këtij trupi dhe mbikëqyrje mbi programet e financuara nga ana e Fondit global për luftë kundër SIDA, tuberkulozit dhe malaries në RM-së, u zgjodh si anëtar i KNM. Kjo paraqet mundësi për bashkëpunim të suksesshëm mes sektorit qeveritar dhe joqeveritar për realizimin e përcaktimeve të përbashkëta strategjike për mbajtjen e prevalencës së ulët të të sëmurëve nga HIV/SIDA dhe TB.

Pleqëri aktive nëpërmjet avokativitetit. Ky projekt është financuar nga ana e Fondit ERSTE dhe KK të Austrisë, ndërsa KK i Maqedonisë angazhohej për rritjen e kyçjes sociale të personave të moshuar si grup qëllimor në të gjitha sferat e jetesës shoqërore. Në muajin shtator u realizua punëtori dyditore për aftësi komunikative, avokativitet dhe lobim dedikuar për personat e moshuar me qëllim përforcimin e kapaciteteve të tyre dhe hasjen e aftësive dhe diturive për zhvillim dhe implemtim të aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes dhe avokativitetin në nivel lokal, kyçje të tyre aktive dhe participimi social në jetën shoqërore. Gjatë muajit nëntor të vitit 2013, përfaqësues të KK të Malit të Zi realizuan vizitë studiu të KKRm-së, në kuadër të projektit për plakje aktive. Qëllimi i vizitës ishte të këmbehen përvojat dhe praktikat e mira mes ekipeve të cilat i implementojnë aktivitetet në vendet e veta. Në kuadër të projektit u botuan 1000 pamflete me informacione dedikuar për personat e moshuar për të drejtat e tyre nga fusha e të drejtës sociale, shëndetësore dhe të pronës.

Ndryshime klimatike – mbrojtja e shëndetit nga ndryshimet klimatike (valë të nxehta, të ftohta). Aktivitetet në pajtueshmëri me planin aksionar për mot të nxehtë filloi në muajin maj me qëllim përgatitjen dhe distribuimin e materialit edukativ informativ për grupe të ndryshme qëllimore për mbrojtje nga valët e nxehta nëpërmjet OKKK në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe qendrave për shëndet publik. Në periudhën prej 15 qershor deri më 15 shtator funksionoi edhe linja SOS për valë të nxehta në kuadër të KK të qytetit të Shkupit me qëllim dhënien e këshillave pa pagesë për mbrojtjen e shëndetit nga valët e nxehta.





DHURIM VULLNETAR TË GJAKUT

Aksione për dhurimin e gjakut. Kryqi i kuq i RM-së dhe Instituti për mjekësi transfuziologjike në vitin 2013 nga 55.000 njësi gjaku të planifikuara realizuan 55.871 njësi gjaku apo obligimet e planifikuara i plotësuan me 101.58% apo për 2.15% rezultat më të mirë nga viti i kaluar.

Në qytetin e Shkupit, organizatat komunale të KK Gazi Babë, Karposh, Kisella Vodë, Qendër dhe Çair në vitin 2013 realizuan 15.481 njësi gjaku apo obligimet e planifikuara i plotësuan me 88.34% dhe në krahasim me vitin 2012 ku u realizuan 13.811 njësi gjaku, arritën rezultate më të mira për 1670 njësi gjaku apo për 10.69%. Në organizatat komunale të Kryqit të kuq nga brendësia, në vitin 2013 u realizuan 39.444 njësi gjaku apo në krahasim me vitin 2012 ku u realizuan 39.598 njësi gjaku, janë arritur rezultate më të dobëta për 154 njësi gjaku.

Obligimet e planifikuara për dhe atë: Berovë 106.78%, Manastir 121.65%, Vallandovë 113.16%, Veles 218.32%, Vinicë 300.18%, Dellçevë 148.22%, Kavadar 155.99%, Kratovë 147.40%, Kriva Pallankë 117.02%, Krushevë 131.43%, Ohër 102.79%, Prilep 105.35%, Probishtip 129.30%, Sh. Nikollë 151.48%, Strugë 102.54%, Shtip 228.05%, Gazi Babë 109.38% dhe Qendër 219.11%/

U hap Qendra ditore për dhurimin e gjakut në "Dare Xhambaz". Më 18 prill të vitit 2013 në "Dare Xhambaz", ministri i shëndetësisë në RM-së z. Nikolla Todorov e hapi Qendrën ditore për dhurimin e gjakut, e para nga ky lloj në Republikën e Maqedonisë. Me Qendrën për dhurimin e gjakut drejtonte Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit në bashkëpunim me Institutin për mjekësi transfuziologjike. Qendrën për dhurimin e gjakut me mjete financiare e ndihmoi dhe e pajisi Qyteti i Shkupit dhe kryetari i qytetit të Shkupit z. Koce Trajanovski, si dhe Ambasada e Sllovenisë në bashkëpunim me kompanitë sllovene në Republikën e Maqedonisë. Në Qendrën ditore për dhurimin e gjakut në "Dare Xhambaz" në Shkup në vitin 2013 u realizuan gjithsej 1.374 njësi gjaku, ku përkaj vetiniciativës për dhurimin e gjakut nga ana e qytetarëve të Shkupit u organizuan edhe disa aksione për dhurimin e gjakut (26 korrik me rastin e shënimit të 50 vjetorit të tërmetit katastrofal në Shkup, SHA Makpetroll, Taksi kompania IN, Rjeti social Twitter, Malla Bogorodica, Alfa Banka, "13 Nëntori" tradicional, Moto klubi Gardian Angels, Kataster, shoqatat e qytetarëve etj).

Aktivitetet të përbashkëta të Klubeve 25 nga Shkupi dhe Nishi. Në periudhën prej 13 – 15 Prill

të vitit 2013 20 anëtarë të rinj të Klubit 25 të KK të qytetit të Shkupit, morën pjesë në takimin punues në organizim të KK të Nishit që u mbajt në Divljana, Bella Pallanka. Takimi kaloi në këmbim të ideve dhe përvojave nga puna e dy klubeve dhe mundësitë për bashkëpunim të përbashkët të ardhshëm në drejtim të promovimit dhe përparimit të dhurimit të gjakut tek popullata e re. Në periudhën prej 25 – 27 gusht të vitit 2013 në Strugë u mbajt vizitë reciproke dhe seminar dedikuar për anëtarët e klubeve 25 nga Shkupi dhe Nishi. Rinia kishte mundësi për herë të dytë të shoqërohen dhe t'i prezantojnë aktivitetet e realizuara në dhurimin e gjakut mes popullatës së re dhe nëpërmjet punës ekipore të krijojnë ide dhe iniciativa të reja që do të kontribuojnë për zhvillimin dhe përparimin e dhurimit të gjakut tek rinia.

Punëtori për edukimin e motivuesve në dhurimin vullnetar të gjakut. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në pajtueshmëri me Programin për organizim dhe përparim të dhurimit të gjakut në Republikën e Maqedonisë në periudhën prej 10 – 12 maj të vitit 2013 në Strugë mbajti punëtori për edukimin e motivuesve për dhurimin vullnetar të gjakut. Në punëtori morën pjesë 20 motivues nga Shkupi, Kumanova, Manastiri, Gostivari, Kërçova, Struga dhe Ohri. U përfshinë përpunues të temave të ndryshme nga fusha e dhurimit të gjakut siç janë motivimi, komunikimi dhe puna ekipore, aktualitete në transfuziologjinë moderne, diseminimi i KK, religjione, shëndetësi, të ushqyerit sipas grupeve të gjakut, trajnime për motivim dhe paragjykim, kuis dhe evaluim.

Aktivitetet të përbashkëta të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë dhe Institutit për mjekësi transfuziologjike. Më 14 dhe 15 dhjetor të vitit 2013 u mbajt punëtori për përforcimin e kapaciteteve dhe bashkëpunimi mes veti mes Kryqit të kuq të RM-së dhe Institutit për mjekësi transfuziologjike. Në këtë takim morën pjesë 30 persona profesional të punësuar nga dy institucionet, u dorëzuan shqyrtime të caktuara kyçe dhe u përgatit Plan operativ për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta në vitin 2014.

Shënimi i Ditës botërore të dhurimit të gjakut – 14 qershor dhe 150 vite aksion humanitar të Kryqit të kuq në botë. Me rastin e Ditës botërore të dhurimit të gjakut 14 qershor dhe shënimi i 150 vjetorit aksion humanitar të Kryqit të kuq në botë, Kryqi i kuq i RM-së organizoi manifestim solemn që u shënuar nën moton "Dhuro dhuratë që do të thotë jetë – dhuro gjak", qëllimi i së cilës ishte ngritja e vetëdijes për nevojën e gjakut të sigurt. Nëpërmjet 150 vullnetarëve në Panairin e Shkupit i prezantuan aktivitetet e Kryqit të kuq në fushën e diseminimit, rinisë, aktiviteteve sociale – humanitare, ndihma e parë, aktivitete shëndetësore – preventive, përgatitje dhe veprim gjatë katastrofave. Në manifestimin sol-





emni mori pjesë kryetari i KK d-r Millço Trajkov, sekretari gjeneral m-r Sait Saiti, Kryetari i Qeverisë së RM-së m-r Nikolla Gruevski, ministri i shëndetësisë z. Nikolla Todorov, ministri i arsimit z. Spiro Ristovski dhe ministri i punës dhe politikës sociale, z. Dime Spasov të cilët i vizituan të gjitha pikat e promovimit në lagjen me tenda dhe e theksuan rëndësinë e veprimit të të gjithë vullnetarëve.

Në shenjë falënderimi për kontributet dhe përkrahjet e tyre në punën e kësaj organizate, sekretari gjeneral i KKRM-së m-r Sait Saiti kryetarit të Qeverisë së RM-së m-r Nikolla Gruevskit ia dorëzoi "Medaljen e artë" dhe i dhuroi qasje në anëtarësi dhe vullnetarizëm, me qëllim që të promovohet puna e KK dhe të tërhiqen njerëz të rinj në organizatë.

Secili prej nesh e ka fuqinë të sjellë vendim që të shpëtohet ndonjë jetë e njeriut, tha kryeministri Nikolla Gruevski, në shënimin e Ditës botërore të dhurimit të gjakut. "Besimi në humanizëm paraqet besim në njeriun dhe besim në parimet që do të thonë tolerancë, përkushtim ndaj vlerave të cilat krijojnë vepra", duke potencuar se dhurimi i gjakut e dërgon porosinë për humanitet dhe solidaritet. Në kuadër të ngjarjes KKRM së bashku me Re – Medika – Spitali i parë privat i përgjithshëm në Maqedoni e promovuan fushatën e përbashkët për ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e dhurimit të gjakut në Maqedoni. Fyrtë mbrojtëse e fushatës "Është super që të jesh i ri, është kull të jesh human" është hendbolisti Naumçe Mojsoski i cili në kuadër të fjalimit të tij theksoi se me një shparje të vogël të gjilpërës i cili nuk dhemb, mund të shpëtohen shumë jetë.

NDIHMË E PARË

Trajnime për vozitës dhe organizata pune. Organizatat komunale të KK dhe KK të qytetit të Shkupit gjatë vitit 2013 mbajtën gjithsej 849 kurse nga ndihma e parë për trajnimin e kandidatëve për vozitës dhe u trajnuan 12.138 persona. Gjithashtu u organizuan 127 kurse nga ndihma e parë për trajnim të personave të punësuar në organizata pune dhe janë trajnuar 747 persona. Në janar të vitit 2013 u fillua me zbatimin e doracakëve të rinj nga ndihma e parë për kandidatë për vozitës dhe certifikata për trajnim të mbaruar për dhënien e ndihmës së parë për persona të lënduar në aksidente trafiku. Këta doracakë dhe certifikata janë bërë në pajtueshmëri me rekomandimet e Qendrës evropiane referente nga ndihma e parë EFAC ku qendron edhe shenja e tyre mbrojtëse. Më 2 shkurt të vitit 2013 u mbajtën dy kurse freskuese për ndihmë të parë për ligjërues dhe demonstratorë nga ndihma e parë për kandidatë për vozitës ku morën pjesë 80 persona prej 24 OKKK.

Më 02 mars të vitit 2013 u mbajt kurs freskues për ndihmë të parë për ligjërues dhe demonstratorë nga ndihma e parë për kandidatë për vozitës ku morën pjesë 39 persona prej të cilëve 29 mjekë – ligjërues dhe 10 demonstratorë. Në trajnim morën pjesë nga OKKK Gostivar, Tetovë, Veles, Gjevgjeli, Manastir, Dibër, Karposh dhe Çair. Më 14 shtator të vitit 2013, organizatat komunale të KK dhe KK të qytetit të Shkupit e shënuan Ditën botërore nga ndihma e parë nën moton “Ndhma e parë dhe siguria në rrugë”.

Trajnim simulues. Më 22 tetor të vitit 2013 u mbajt trajnim simulues në Gostivar “Aksident rrugor me numër të madh të të lënduarve dhe me djegie” ku përkaj ministrisë së shëndetësisë, MPB, Spitali Gostivar, Komuna Gostivar, Njësia e zjarrfikësve dhe QMK, morën pjesë KKRM dhe OKKK. Qëllimi i trajnimit ishte që të ngritet shkalla e përgatitjes gjatë gjendjeve në krizë me prioritet në sigurinë shëndetësore. Kryqi i kuq mori pjesë me grimues dhe grime për paraqitje reale të plagëve dhe lëndimeve dhe manekinë.


Trajnimi për përdorimin e defibrilatorit të jashtëm. Në dhjetor të vitit 2013, Kryqi i kuq i RM-së zbatoi trajnim nga ndihma e parë dhe përdorim të defibrilatorit automatik të jashtëm për 80 persona profesional të punësuar nga ministrinë shtetërore, institucionet dhe agjencitë.

Bashkëpunimi me Ministrinë për punë të brendshme – sektori për çshtje kufitare dhe migrime. Në bashkëpunim me ministrinë për punë të

brendshme – sektori për çshtje kufitare dhe migrime, në periudhën prej 15 – 28 qershor edhe gjatë muajit shtator të vitit 2013, në zyrat për ndihmë të parë në OKKK Kumanovë, Kriva Pallankë, Dellçevë, Berovë, Strumicë, Gjevgjeli, Kavadar, Manastir, Resnje, Ohër, Dibër, Tetovë dhe KK i qytetit të Shkupit u realizuan trajnime për ndihmë të parë me 490 përfaqësues të policisë kufitare. U përfshinë më shumë përmbajtje tematike nga ndihma e parë.

Garë shtetërore e ekipeve nga ndihma e parë.

Më 20 – 21 shtator të vitit 2013 në Strugë u mbajt Gara e 22-të shtetërore e ekipeve nga ndihma e parë. Në garë morën pjesë 24 ekipe nga ndihma e parë të OKKK. Gara u realizua në dy trajektore A dhe B, me 7 baza pune prej të cilave katër ishin nga fusha e ndihmës së parë, njëra bazë ishte nga fusha e diseminimit përderisa dy bazat tjera ishin me karakter rekreativ – argëtues. Për herë të parë në garat shtetërore nga ndihma e parë në një bazë pune punohej trijazhi gjatë fatkeqësisë masive dhe u vlerësuan 8 lëndime. Gara shtetërore e ekipeve nga ndihma e parë u mbajt në dy ditë. Vendi i parë në këtë garë i takoi ekipit për ndihmë të patë të OKKK Kisella Vodë, vendi i dytë i takoi OKKK Ohër përderisa vendi i tretë i takoi ekipit nga ndihma e parë të OKKK Karposh. Në bazën për diseminim më e mira ishte OKKK Probishtip e cila e mori vendin e parë për njohjen e Lëvizjes, vizionit dhe misionit të Kryqit të kuq.





QËLLIMI STRATEGJIK 3

PËRPARIMI I KYÇJES SOCIALE DHE KULTURA E MOS DHUNËS DHE PAQES

Politika për veprimtari sociale – humanitare.

Kryqi i kuq i RM-së gjatë vitit 2013 e solli Politikën për veprimtari sociale – humanitare e cila paraqet bazë të veprimit të shoqatës nacionale për përgjigje në situata urgjente sociale, si dhe për implementimin e programeve për zhvillim të përhershëm social. Me këtë politikë janë rregulluar vëllimi dhe përgjegjësitë e KKRМ-së sipas së cilave duhet të sigurohet përkrahja e OKKK në realizimin e aktiviteteve programore në veprimtarinë sociale – humanitare.

Përmirësimi i socializimit të fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të posaçme. Kryqi i kuq i RM-së në bashkëpunim me Entin për punë sociale pesë vite me radhë implementon iniciativa të përbashkëta për përmirësimin e socializimit të fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të posaçme. Prej vitit 2011 Banka komerciale SHA Shkup është sponsor dhe partner i yni i cili në mënyrë aktive është kyçur në implementimin e aktiviteteve projektuese. Në kuadër të projektit u organizua punëtorja informative me përfaqësues të organi-

zatave komunale të KK Prilep, Kavadar, Veles, Gostivar, Kërçovë, Dellçevë, Dibër dhe KK i qytetit të Shkupit, qendrat ditore të fëmijëve me nevoja të posaçme dhe përfaqësues të Entit për punë sociale, me qëllim që të jepen kahje për implementim të përbashkët të aktiviteteve.

Prej 09 deri më 11 qershor të vitit 2013 në Strugë, u organizua punëtorja edukative me qëllim që të përfitohen disa dituri dhe aftësi për qasje dhe përkrahje të fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të posaçme. U realizuan iniciativa të përbashkëta në komuna, dhe atë: vizitë në shtëpitë e familjeve kujdestare nga ana e ekipeve mobile të përbërë nga vullnetarë të Kryqit të kuq, punëtorja krijuese, ekspozita humanitare shitëse, organizim të aktiviteteve rekreative, edukime për fëmijët, prindërit dhe kujdestarët e fëmijëve, përkrahje psikologjike për fëmijët dhe prindërit dhe shumë aktivitete tjera.

Më 18 dhjetor të vitit 2013 u organizua punëtorja për evaluimin e aktiviteteve projektuese me qëllim që



të vërtetohen rezultatet e arritura, efektet nga implementimi i aktiviteteve, si dhe të jepen kahje për veprim në të ardhmen në nivel lokal.

Zhvillim i përbashkët i bashkësisë – ZHPB. Projekti “Zhvillim i përbashkët i bashkësisë” edhe gjatë vitit vazhdoi të implementohet nëpërmjet Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit në bashkësinë e mjeruar rromë në komunën Shuto Orizarë, lagje ku janë përfshirë rreth 400 persona. Aktivitetet projektuese u realizuan në bashkëpunim dhe përkrahje të EVN Maqedoni. Në kuadër të këtij projekti më 10 maj të vitit 2013 në mënyrë zyrtare u hap Qendra për përkrahjen e të rinjve. Në këtë hapje morën pjesë Ministri i punës dhe politikës sociale z. Spiro Ristevski, z. Verner Hengst – Kryetar i Këshillit drejtues të KKRМ-së dhe z-nja Suzana Tuneva – Paunovska – Sekretar i Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit. Me hapjen e këtij lloji të Qendrës për përkrahjen e të rinjve, rinia kanë mundësi të jenë vullnetarë aktiv të Kryqit të kuq të organizojnë punëtorë të ndryshme edukative, ligjërata etj. aktivitete me të cilat në mënyrë të dobishme do ta plotësojnë kohën e tyre të lirë.

Lufta kundër tregtisë me njerëz. Aktivitetet e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë për preventivë nga tregtia me njerëz u implementuan nëpërmjet organizatave komunale të KK Strumicë, Strugë, Dibër, Manastir, Resnje, Gjevgjeli, Kavadar, Ohër, Shtip, Kumanovë si dhe KK të qytetit të Shkupit. Gjatë vitit 2013 janë shpërndarë materiale promovuese, gjithsej 1000 fletushka edukative dhe 500 pamflete në gjuhën shqipe dhe maqedonishte për nevojat e nxënësve të shkollave fillore dhe mesme në 11 qytete. Nëpërmjet edukatorëve moshatar të organizatave komunale të KK janë organizuar gjithsej 112 punëtorë ku morën pjesë 2792 nxënës.

Në Gjevgjeli u mbajt trajnim me mesimdhënës të shkollave fillore dhe të mesme dhe nëpërmjet tyre në orët e mësimi është mbajtur edukimi i 1000 nxënësve. Me rastin e Ditës ndërkombëtare të luftës kundër tregtisë me njerëz “18 Tetori” janë organizuar më shumë ekspozita kreative dhe pika promovuese. Gjatë shënimit të “Java për luftë kundër tregtisë me njerëz” janë organizuar punëtorë edukative dhe pika promovuese në Shkup, Strugë, Kavadar, Shtip, Manastir, Dibër dhe Ohër. Gjatë vitit janë organizuar dy trajnime për 15 edukatorë të rinj për edukim moshatar të të rinjve për preventivë nga tregtia me njerëz. Janë organizuar tre forum teatro në Strugë, Strumicë dhe Dibër me të rinjtë e shkollave fillore dhe të mesme.

Aktivitetet për përkrahje dhe kujdes për personat e moshuar. Klubi “Jetë dinjitoze” pranë Organizatës komunale të Kryqit të kuq Kriva Pallankë, ku në mënyrë aktive anëtarësojnë 40 persona dhe gjatë vitit 2013 me përkrahjen e KK të Gjermanisë në Baden Vitemberg realizoi aktivitete të drejtuara

kah kyçja e personave të moshuar në aktivitetet shoqërore të bashkësisë dhe përditshmëri të plotësuar. Qëllimi themelor është përmirësimi i kualitetit të jetës së personave të moshuar, nëpërmjet përmirësimit të gjendjes së tyre psikologjike, punëtorë edukative dhe kreative, hasje të aftësive dhe komunikimeve të reja, kujdes për shëndetin e tyre, si dhe ndihmë humanitare. Gjatë vitit janë realizuar më shumë aktivitete: punëtorë edukative, punëtorë kreative, aktivitete rekreative, kontrollime shëndetësore etj. Klubi i pensionistëve “Anri Dinan” nëpërmjet organizatës komunale të Kryqit të kuq Negotinë me të cilin janë përfshirë gjithsej 30 persona vazhdoi në mënyrë aktive të funksionojë edhe gjatë vitit 2013. Gjithashtu edhe nëpërmjet këtij klubi u implementuan punëtorë edukative dhe kreative, aktivitete rekreative etj.

Projekti “Qendra ditore për persona të moshuar dhe qendra për dhënien e ndihmës në kushte shtëpiake” paraqet servis zyrtar nëpërmjet të cilit janë zhvilluar dhe përparuar forma jashtë institucionale për mbrojtjen e personave. Projekti u realizua me marrëveshje mes tre palëve mes qytetit të Shkupit, Ministrisë për punë dhe politikë sociale të RM-së dhe KK të qytetit të Shkupit. Në këtë projekt vizitohen 60 persona të moshuar të cilët jetojnë vet apo me bashkëshort-in/en në rajonin e komunave Kisella Vodë, Qendër, Shuto Orizarë, Çair dhe Butel. Janë angazhuar dy motra medicinale të cilat japin shërbime mjekësore për personat e moshuar, ndërsa nga ana e 14 vullnetarëve sigurohen shërbime sociale për personat e moshuar në shtëpitë e tyre. Në Qendrën ditore organizohen aktivitete të llojllojshme me të cilat përfshih mbi 100 persona të moshuar të cilët në mënyrë aktive janë të kypur në implementimin e aktiviteteve të llojllojshme: kontrollime edukative, kreative, shëndetësore pa pagesë, matje të nivelit të sheqerit në gjak etj.

Kryqi i kuq i RM-së me aktivitete e shënoi edhe **1 Tetori – Dita botërore e personave të moshuar.** Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit në bashkëpunim me Institutin për entologji dhe antropologji pranë FNM bënë promovimin e filmit me tematikë për personat e moshuar – “Si dje të isha lindur”. Organizatat komunale të KK Kriva Pallankë dhe Veles organizuan punëtorë edukative ku morën pjesë anëtarë të klubit dhe pensionistë të bashkësisë. Anëtarë të Klubit “Jetë dinjitoze” e vizituan Çerdhen për fëmijë “Detelinka” ku me fëmijët mbajtën punëtorë të përbashkët.

Kryqi i kuq i RM-së me rastin e shënimit të “Java e kujdesit për persona të moshuar” më 18 nëntor organizoi pres konferencë ku mbajtën fjalim Ministri për punë dhe politikë sociale z. Dime Spasov, Kryetari i Këshillit drejtues të EVN Maqedoni z. Verner Hengst dhe Sekretari gjeneral i KKRМ-së z. Sait Saiti. Në pres konferencën u promovuan aktivitetet e përbashkëta

të cilat u realizuan prej 18 deri 24 nëntor të vitit 2013 nën moton: "Ne dëshirojmë, Ju dini, Së bashku mundemi". Qëllimi ishte të ngrihet vetëdija e popullatës për të drejtat e personave të moshuar si dhe nevoja për kujdes dhe ndihmë për personat e moshuar. Në këtë ngjarje në mënyrë zyrtare u dorëzua donacioni i EVN Maqedoni për përkrahjen e aktiviteteve për kujdesin e personave të moshuar në kushte shtëpiake të cilat Kryqi i kuq i RM-së i implementoi nëpërmjet KK të qytetit të Shkupit dhe OKKK Veles, Kriva Pallankë, Kërçovë dhe Dibër. Në kuadër të javës me aktivitete të ndryshme u përfshinë gjithsej 4626 persona të moshuar. Përkaj aktiviteteve tjera u organizua edhe aksion për matje pa pagesë të nivelit të sheqerit në gjak për 2000 persona të moshuar, për çka EVN Maqedoni siguroi lenta dhe lançeta për marrjen e gjakut. Me rastin e javës u përgatit broshurë për të drejtat e personave të moshuar nga mbrojtja sociale dhe shëndetësore në bashkëpunim me Entin për mbrojtje sociale dhe Shtëpinë shëndetësore në Shkup, ndërsa e njëjta u botua me përkrahjen e EVN Maqedoni.

Fushata për preventivë nga keqpërdorimi seksual dhe pedofilia. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë tre vite me radhë në mënyrë aktive ishte i kyçur në implementimin e aktiviteteve për preventivë nga keqpërdorimi seksual dhe pedofilia në kuadër të fushatës e cila u organizua nga ana e Ministrisë për punë dhe politikë sociale. Me qëllim të merren njohuri për atë që është ndërmarrë në periudhën pas mbarimit të fytës së dytë, si dhe për nevojën për organizimin e aktiviteteve informative me prindërit e fëmijëve në shkollë, ekipet lokale përfaqësues të Kryqit të kuq dhe Qendrave për punë sociale në Shkup dhe 17 komunave në vend, janë bërë harta në shkollat fillore dhe të mesme. Në bazë të hartës për nevojën për të vazhduar aktivitetet, u përgatitën plane për aksion, në bazë të të cilave u implementuan aktivitete në periudhën prej 10 maj deri më 10 qershor të vitit 2013.

Pushim dhe rekreacion për fëmijët e familjeve në rrezik social dhe fëmijë shfrytëzues të shtesave të posaçme. Kryqi i kuq i RM-së gjatë muajit janar të vitit 2013 u kyç në realizimin e projektit për pushim dimëror pa pagesë për fëmijët e familjeve në rrezik social dhe për fëmijët shfrytëzues të shtesave të posaçme të cilin e implementoi Ministria për punë dhe politikë sociale. Në tre ndrrime në pushimoren "Ilinden" në Mavrovë dhe dy ndrrime në pushimoren "Pelister" Manastir, vullnetarët të Kryqit të kuq u angazhuan si edukatorë dhe si persona shoqëruar për fëmijët edhe gjatë qëndrimit të tyre realizuan aktivitete rekreative, edukative dhe edukuese në pajtueshmëri me moshën dhe nevojat e shfrytëzuesve të shërbimeve. Ministria për punë dhe politikë sociale këtë projekt e implementoi edhe gjatë periudhës verore.

Vullnetarët e angazhuar – edukatorë / bashkëpunëtorë profesional të organizatave komunale të KK edhe gjatë muajve korrik dhe gusht i shoqëruan dhe realizuan aktivitete me fëmijët në pushimoret për fëmijë "Pelister" – Manastir dhe "Majski cvet" – Strugë.

Aksion humanitar "Zgjohuni human 5". Për herën e pestë me iniciativë të KK të qytetit të Shkupit dhe Studio Moderna Shkup, Kryqi i kuq i RM-së e përkrahi aksionin humanitar "Zgjohuni human" dhe e zgjeroi nëpër të gjitha organizatat komunale të KK në vend. Qëllimi i këtij aksioni humanitar ishte nxitja e humanitetit dhe përmirësimi i kushteve për jetë për kategorinë e mjeruar të personave nëpërmjet grumbullimit të dyshekëve të përdorur, si dhe shtretërve dhe dhurimi i tyre në institucione të cilat kujdesen për ata (spitale, institucione për kujdesen e më shumë grupeve qëllimore dhe shtëpi ndëshkuese). Pas aksionit të mbaruar, dyshekët dhe shtretërit e dhuruar organizatat komunale të KK i dhuruan në institucione sociale apo shëndetësore.

Projekti "Kujdesemi për shtëpi të ngrohtë". Ministria e punës dhe politikës sociale në bashkëpunim me KCRM-së më 29 korrik të vitit 2013 filloi me implementimin e Projektit "Kujdesemi për shtëpi të ngrohtë" me qëllim uljen e rrezikut social nga çkycja sociale e qytetarëve të vendit në kënaqjen e nevojave elementare për shtëpi, mobile, teknike të bardhë, aparate elektrike, aparate për shtëpi, pajisje për fëmijë, biçikleta etj. Për promovimin e aktiviteteve projektuese, Ministria për punë dhe politikë sociale përgatiti materiale promovuese: TV spot, pamflete dhe fletushka. Qytetarët e interesuar patën mundësinë që ta dhurojnë ndihmën në numrin e telefonit pa pagesë i cili ishte i hapur për këtë qëllim, nëpërmjet OKKK, si dhe në qendrat për punë sociale. Ndihma u shpërnda në pajtueshmëri me qytetarët e evidentuar të cilët kishin nevojë për këtë lloj ndihme.

Shënimi tradicional i "Java e solidaritetit". Kryqi i kuq i RM-së nën moton: "Kontributi juaj – ndihmë e vlefshme" duke filluar nga 22 deri më 28 prill të vitit 2013 me aktivitete e shënoi në mënyrë tradicionale "Java e solidaritetit". Në kuadër të Javës Kryqi i kuq organizoi Aksion grumbullues me qëllim që të zgjohet ndjenja e humanizmit dhe solidaritetit tek qytetarët, posaçërisht tek gjenerata e re për ndihmë dhe përkrahje reciproke, si dhe të sigurohet ndihmë adekuate për kategoritë e mjeruara të popullatës. U sigurua ushqim 4.870 kg, rroba 16.087 kg, 1034 palë mbathje, 71 kg mjete për higjienë. U organizua aksion "Prej shtëpie në shtëpi" ku vullnetarët e OKKK vizituan familje në shtëpitë e tyre si donatorë dhe përkrahës të mundshëm të aksionit humanitar. Në këtë aksion qytetarët dhuruan gjithsej 368.575 denarë. Mjetet e grumbulluara nga aksioni u dedikuan për sigurimin e ndihmës në ushqim për familjet e ballafaquara me



rrezik të caktuar social të cilët jetojnë në mjedise rurale: persona të moshuar dhe persona me nevoja të posaçme.

Fushata për "Dita e urisë". Dita botërore e urisë shënohet që të ngrihet vetëdija e njerëzve për problemin me urinë, si dhe për arritjet e miliona njerëzve të cilët e kanë tejkaluar problemin me urinë dhe i kënaqin nevojat e tyre. Kryqi i kuq i RM-së me këtë rast u kyç në shënimin e 16 Tetorit me organizimin e fushatës nën moton "Mendoni edhe për ne". Në kuadër të fushatës u organizuan aktivitete humanitare në bashkëpunim me institucionet arsimore – edukative, në bashkëpunim dhe përkrahje të kompanive dhe qytetarëve, si dhe në bashkëpunim me sektorin qytetar. Gjithashtu u organizua edhe aksion për sigurimin e mjeteve financiare nga sektori korporativ ku u grumbulluan gjithsej 110.246 denarë. Me ato të holla u siguruan 180 pako me ushqim të cilat iu ndanë popullatës së mjeruar në vend. Për herë të katërt ky aksion u përkrah nga Posta e Maqedonisë SHA Shkup, e cila mundësoi pa pagesë të dorëzohen 13.000 fletushka në kompanitë për pjesëmarrjen dhe përkrahjen e tyre në këtë aksion. Aksioni u

përkrah edhe nga ana e Odës ekonomike të RM-së. Lidhjes së odave ekonomike të Maqedonisë dhe Oda ekonomike e Maqedonisë veriperëndimore të cilat i informuan kompanitë e tyre anëtare në vend që të kyçen dhe të japin përkrahje në këtë fushatë. Mbulues medial i fushatës ishte TVM, i cili përpunoi TV spot. Në fushatë u siguruan gjithsej 727.668 denarë, të cilat ishin të dedikuara për furnizimin e ushqimit. Nga ushqimi i grumbulluar dhe i furnizuar gjithsej janë siguruar 19.541 kg ushqim dhe 7.250 kg rroba dhe të njëjtat iu janë ndarë personave në rrezik social.

Seminar për migrime. Kryqi i kuq i RM-së në bashkëpunim dhe përkrahje të Kryqit të kuq të Suedisë, duke filluar prej muajit tetor të vitit 2012, vazhdimisht realizon aktivitete për reintegrimin e qytetarëve të Maqedonisë, të cilët pas vendimit negativ në kërkesë të tyre për azil në Suedi, kthehen në Republikën e Maqedonisë. Me qëllim përforcimin e ndikimit në këtë fushë dhe përhapja e informacioneve dhe diturive për migracionet. KKRМ-së, organizoi seminar me temë Migracione, që u mbajt prej 21 deri më 23.08.2013 në Qendrën për edukim dhe rekreacion "Solferino" në Strugë. Nga ana e përfaqësuesve

të KK të Suedisë u prezantuan aktivitete të cilat i ndërmerr shoqata nacionale, si dhe u ndanë informacione për procedurën për njohjen e azilit në vendin e tyre. Në këtë punëtori u paraqitën edhe aktivitete të cilat i ndërmarrin institucionet qeveritare në vend në bazë të migracioneve.

Bashkëpunim dhe përkrahje nga Kryqi i kuq i Gjermanisë në Baden Virtemberg. Prej 12 deri më 14 mars të vitit 2013 z. Hans Miler përfaqësues i Kryqit të kuq të Gjermanisë në Baden Virtemberg e vizitoi Kryqin e kuq të RM-së, me të cilën organizatë realizohet bashkëpunim dhe përkrahje afatgjate të frytshme në njëzet vitet e kaluara. Gjatë vizitës së tij u realizua takim me Sekretarin gjeneral të KKRMsë z. Sait Saiti i cili shprehi falënderim për përkrahjen e deritanishme, si dhe për ndihmën humanitare të dhuruar në krevate për spitale, orman për krevate, elemente për larjen e sistemeve për spitale, roba etj. në vlerë prej 21.900 euro. Ndihma ishte e dedikuar për institucione shëndetësore dhe për popullatën e mjeruar në vend.

Për nevojat e Qendrës ditore për fëmijë me nevoja të posaçme në Dibër, KK në Baden Virtemberg nëpërmjet Organizatës komunale Dibër siguroi pajisje adekuate, u bë hyrje për në qendër, si dhe u rregullua oborri i qendrës ditore. Gjatë muajit korrik u sigurua ndihmë humanitare automjet ambulancë për nevojat e Njësisë për përgjigje gjatë katastrofave pranë KKRMsë, si dhe ndihmë në krevate për spitale, ormanë, roba etj. Ndihma iu nda institucioneve shëndetësore, ndërsa kontejneri u vendos në vend publik në Shkup

ku qytetarët mund të dhurojnë roba të përdorura për personat të cilët kanë nevojë për ndihmë të tillë. Gjatë muajit shtator dhe dhjetor gjithashtu u sigurua ndihmë krevate për spitale, ndihmëse për persona me invaliditet, roba etj. me vlerë prej 33.600 euro.

Përkrahje për nënat të cilat kujdesen vet. Me përkrahjen e KK të Gjermanisë në Baden Virtemberg duke filluar nga muaji mars deri në qershor të vitit 2013 nëpërmjet OKKK Negotinë u implementua projekti "Ndihmoi gruas së pambrojtur, përsosë aftësoje". Qëllimi i projektit ishte të sigurohet përkrahje për 28 nëna nëpërmjet të cilit u mundësua hasja e aftësive dhe diturive të reja dhe për edukimin e nënave. Nëpërmjet këtij klubi artikulohen të gjitha kërkesat dhe nevojat e nënave, kanë katin e tyre dhe i ndajnë problemet, mësojnë, këmbëjnë përvoja, lobi të përbashkët tek punëdhënësit potencial dhe shumë aktivitete tjera.

Bashkëpunim i përbashkët me Alfa Banka. Kryqi i kuq i RM-së së bashku me Alfa Banka SHA Shkup më 2 qershor të vitit 2013 në mënyrë zyrtare e shënuan fillimin e nevojës së 6 kontejnerëve për dhurimin e rrobave dhe 15 kasave për dhurim të të hollave të vendosura në vende publike në qytetin e Shkupit. Ky aktivitet qëllimi i së cilit është të sigurohet ndihmë efektive materiale për më të rrezikuarit me përkrahjen e përgjegjësishë shoqërore tek qytetarët u implementua me përkrahjen e Alfa Bank e cila kompani në këtë mënyrë e shënoi Ditën vullnetare në nivel të të gjithë grupacionit. Vendosija e konte-



jnerëve paraqet qasje të re të dhurimit të rrobave dhe qytetarët mund t'i dhurojnë rrobat në çdo kohë. Në pajtueshmëri me sasinë e grumbulluar të rrobave, kontejnerët rregullisht zbrazen, të njëjtat klasifikohen dhe iu ndahet popullatës së mjeruar të cilat kanë nevojë për ndihmë të tillë.

Përkrahje e vazhdueshme nga Vezë Sharri – Tetovë. Kompania Vezë Sharri nga Tetova si rezultat i bashkëpunimit të frytshëm me KKRМ-së gjatë vitit të kaluar, përkrahja për Pikën për të pa strehuarit të KK të qytetit të Shkupit vazhdoi ta realizojë edhe në vitin 2013. Kjo kompani deri në fund të vitit për çdo muaj ka siguruar ushqim nga prodhimet e veta (vezë dhe prodhime mishi) për nevojat e Pikës. E njëjta është hapur të hënën kur të pa strehuarit marrin edhe shërbime higjienike dhe të premtën kur marrin edhe rroba të pastra, kontrollime mjekësore dhe medikamente të patjetërsueshme, bisedime dhe këshilla nga psikologu, si dhe haje dhe pije të ngrohta.

Donacion nga Gjysmëhëna e kuqe e Turqisë. Gjatë muajit tetor përfaqësues të Gjysmëhënës së kuqe të Turqisë e vizituan KKRМ-së të cilët dhanë donacion në rroba të reja me vlerë prej 100.325 dollarë. Kjo ndihmë humanitare nëpërmjet OKKK dhe KK të qytetit të Shkupit u shpërnda për nevojat e familjeve të rrezikuara sociale.

Donacion nga Kryqi i kuq i Austrisë. Përfaqësues të KK të Austrisë në muajin tetor dhanë donacion 75 krevate dhe ormanë për spitale, ndihmë e cila në bashkëpunim me Ministrinë e shëndetësisë u shpërnda për nevojat e institucioneve shëndetësore në vend.

Aksion humanitar “Të ndajmë lumturi”. Kryqi i kuq i RM-së në bashkëpunim dhe përkrahje të EVN Maqedoni organizoi aksion të përbashkët humanitar “Të ndajmë lumturi”. I gjithë ky aksion ishte që të dhurohet buzëqeshje dhe lumturi për fëmijët e familjeve të rrezikuara sociale dhe për fëmijët me nevoja të posaçme, si dhe të ndahen momente gëzimi për Festat e Vitit të Ri. Për këtë aksion u siguruan 700 dhurata për Vitin e Ri, donacioni i EVN Maqedoni. Në periudhën prej 19 deri më 30 dhjetor të vitit 2013 nëpërmjet KK të qytetit të Shkupit dhe OKKK në bashkëpunim me të punësuarit e EVN Maqedoni në Shkup, Koçan, Kërçovë, Strugë, Shtip, Gjevgjeli dhe Strumicë u organizuan ngjarje ku u ndanë dhuratat për secilin fëmijë shall, kapelë, doreza dhe çokollatë. Më 19.12.2013 KK i qytetit të Shkupit iu mundësoi 150 fëmijëve që të përcjellin shfaqje në Operën dhe baletin e Maqedonisë, të cilëve iu ndanë dhurata nga ana e anëtarit të Këshillit drejtues të EVN Maqedoni z. Igor Gievski, Ministri i punës dhe politikës sociale z. Dime Spasov dhe sekretari gjeneral i KKRМ-së z. Sait Saiti të cilët fëmijëve iu dëshiruan festa të lumtura për Vitin e Ri dhe ditë pa brenge në Vitin e Ri.



DISEMINIM

Edukimi dhe përhapja e diturive për Kryqin e kuq nxit zbatim praktik të vlerave universale dhe parimeve themelore si paqe, tolerancë, mosdhunë, kulturë dialogu, vlera humane, tolerancë dhe raport aktiv ndaj jetës, mosdiskriminim dhe praktikë të arsimit humanitar.

Zbatim praktik i parimeve themelore. Me qëllim që të përparohet puna për diseminim në teren është përpunuar politikë për diseminim të KKRMs-së. Për qasje të unifikuar, gjithashtu është reviduar doracaku për diseminim të përgjithshëm dhe është plotësuar me informacione të reja dhe sqarime. Është përpunuar analizë e planit strategjik për diseminim të KKRMs-së 2011 – 2013 që paraqet evaluimin e aktiviteteve të zbatuara, kontribute dhe rezultate të arritura.

Edukim humanitar. KKRMs-së, nëpërmjet mjetit për edukim humanitar, Kryqi i kuq në Aksion – Promovimi i vlerave humane u kyç në listën zyrtare të Federatës Ndërkombëtare si pjesë e platformës arsimore. Mësimi për rregullat e Të Drejtës ndërkombëtare humanitare, kultura si sistem i vlerave, migracioneve dhe formate tyre të veprimit në botë janë pjesë e temave të cilat ishin të përfshira në kuadër të këmbimit rinor ku KKRMs-së me pesë përfaqësues të vet mori pjesë prej 26 – 03 korrik të vitit 2013 në Londondëri, Irlandë Veriore. Qëllimi i projektit ishte promovimi i edukimit humanitar dhe krijimi i bashkësive elastike ku rinia janë të inspiruar, nxitur dhe të përkrahur të promovojnë dhe të ndërmarrin aksion humanitar.

E Drejta Ndërkombëtare Humanitare. Viti 2013 solli një mori aktiviteteve dhe bashkëpunime të reja për përparimin e punës dhe programit për të drejtën ndërkombëtare humanitare. Më 09.04.2013 u mbajt mbledhja e Komitetit nacional për DNH, ku morën pjesë përfaqësues të Ministrive të cilat janë pjesë e këtij trupi, si dhe përfaqësues të DNH të KKRMs-së. Në kuadër të zhvillimit të bashkëpunimit me institucionet për arsim të lartë të cilat e kyçin mësimin e DNH, Akademia ushtarake "Gjeneral Mihajlo Apostollski" dhe Fakulteti juridik "Justiniani i Parë", filluan me realizimin e aktiviteteve të Klubit për DNH të KKRMs-së pranë këtyre institucioneve.

Punëtorja njëditore me temë "NATO dhe e drejta ndërkombëtare humanitare (DNH)", u mbajt më 02 Prill të vitit 2013 në organizim të Këshillit euroatlantik të Maqedonisë dhe KKRMs-së. Përkaj pjesës tradicionale për bazat e DNH-së, punëtorja u kthye edhe në sfidat e kësaj të drejte në kontekst bashkëkohor, posaçërisht me aspekt të operacioneve paqësore dhe menaxhimi me terrorizmin.

Më 25.04.2013 u mbajt takim me Mishell Saad,



delegat i KNKK nga Franca ku u diskutua për sfidat, përvojat dhe misioni i KNKK ku morën pjesë studentët e fakulteteve juridike dhe vullnetarët e KKR-së.

Në periudhën prej 5 – 6 qershor të vitit 2013 u mbajt trajnim dyditor rajonal me temë "Implementimi i të drejtës ndërkombëtare humanitare" në organizim të Ministrisë për mbrojtje, në kuadër të së cilës u mbajt diseminim për KKR-së dhe misionin e KNKK-së. Gjithashtu KK i Maqedonisë mori pjesë në konferencën ndërkombëtare për Vëzhgim të të drejtës ndërkombëtare humanitare që u mbajt prej 04 – 08 shtator të vitit 2013 të organizuar nga ana e Komitetit ndërkombëtar të KK.

Kryqi i kuq i RM-së mori pjesë edhe në "Takimin rajonal të profesorëve për të drejtë ndërkombëtare humanitare" që u mbajt më 24 – 25 tetor të vitit 2013 në Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë, në organizim të Zyrave rajonale të KNKK-së ku morën pjesë tre përfaqësues, profesorë dhe vullnetarë të shoqatës nacionale.

Promovimi i vlerave humanitare. Me përkrahje të programit CIVICA Mobilitas të implementuar nga CIR-s dhe përkrahur në mënyrë financiare nga Agjencia zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim, të përfaqësuar nga Zyra për bashkëpunim në Shkup gjatë vitit 2013 u implementua programi për promovim të vlerave humane nëpërmjet së cilës u realizuan 202 projekte të vogla për mirëqenien e bashkësisë dhe u ndihmuan 3327 persona në vend. Gjithsej 1368 të rinj, vullnetarë potencial e kaluan trajnimin për diseminim dhe 1247 të rinj e përcollën trajnimin për përpunimin e projekteve të vogla. U mbajtën 3 punëtori finale ku morën pjesë 131 të rinj dhe përfaqësues të projekteve më të mira.

Gjithashtu 28 diseminatorë dhe 16 mysafirë të organizatave të ndryshme patën mundësi të jenë pjesë e këtyre punëtorive finale. Gjatë tre punëtorive finale dyditore, rinia morën dituri të zgjeruara për kulturën si sistem i vlerave dhe kahjeve për vullnetarizim në organizatat e tyre komunale lokale dhe gjithsesi drejtime për shënimin e Javës PVH.

Në periudhën prej 21 – 27 shtator u shënuar java e promovimit të vlerave humane. Nën moton "Promovimi i ndryshimeve" u përgatit "Shou PVH" në OKKK. Ata paraqitën mundësi për promovimin e ndryshimeve të shprehur nëpërmjet gjuhës, kulturës dhe vallëzimit. Në territorin e RM-së u realizuan "Shou PVH" – ngjarje në gjithsej 30 OKKK dhe KK të qytetit të Shkupit, me kyçje të 863 të rinjve në paraqitjen e shfaqjeve, dhe të njëjtat u ndoqën prej 6739 shikuesve, prindërve, arsimtarëve, nxënësve, medie.

Me shpërblimin OSKAR PVH u dekoruan të rinjtë e OK Kërçovë. Ata përpunuan film me titull "Jeta e një vullnetari PVH". Rinia e këtij klubi ishin delegacioni zyr-

tar të cilët e dorëzuan vauçerin me vlerë prej 165.000 denarëve për personat e mitur të vendosur në Burgun në Ohër në shënimin e 5 dhjetorit, Dita ndërkombëtare e vullnetarëve që u mbajt në Muzeun e Luftës revolucionare të Maqedonisë në Shkup. Manifestimi i PVH vazhdoi edhe këtë vit me qëllim promovimin e aktiviteteve, rinisë dhe diseminatorit. Këtë vit fitoi OK Veles ku rinia përpunoi 8 projekte, prej të cilave 2 me Diell.



MENAXHIMI ME VULLNETARË

Kryqi i kuq i RM-së, si pjesë e Federatës ndërkombëtare të KK dhe si organizatë me numër më të madh të vullnetarëve aktiv të kyçur në vend vazhdimisht punon në përparimin e menaxhimit me vullnetarë, dhe kontributet e veta i drejton kah respektimi i të drejtave dhe obligimeve të secilit vullnetar.



Zhvillimi strategjik. Është përpunuar analiza e planit strategjik për vullnetarizëm të KKRМ-së 2008 – 2013 me çka është bërë evaluimi i kontributeve dhe qëllimeve të arritura.

Kyçje në debatet publike për zhvillimin e vullnetarizmit. Kryqi i kuq i RM-së në mënyrë aktive u kyç në debatet publike për përparimin e ligjit për vullnetarizëm dhe planin strategjik për zhvillimin e vullnetarizmit në RM-së në organizim të organizatave joqeveritare Rinia Info dhe Konekt, si dhe kyçje në punën e Këshillit nacional për zhvillimin e vullnetarizmit në RM-së.

Pjesëmarrje në analiza të jashtme për krahasim të kapaciteteve vullnetare. Viti 2013 rezultoi me kyçje në vëzhgimet e nivelit nacional dhe ndërkombëtar të realizuar nga ana e organizatës joqeveritare Konekt dhe federata ndërkombëtare e KK me qëllim krahasimin e kapaciteteve vullnetare dhe mënyrën e veprimit të shoqatës nacionale në pjesën e menaxhimit me vullnetarë.


Vëzhgimi i motiveve për vullnetarizëm. Është zbatuar vëzhgim interno në bashkëpunim me Institutin zviceran për teknologji në Cyrih i cili kyç anketimin e rreth 500 vullnetarëve të KKRМ-së me qëllim që të vëzhgohen motivet për vullnetarizëm në shoqatën nacionale, krahasuar me shoqatat tjera nacionale.

Përparimi i bashkëpunimit me sektorin joqeveritar për këmbim të aktiviteteve vullnetare dhe zhvillimit të përbashkët. Është realizuar punëtori me 28 vullnetarë të 10 vendeve evropiane për aktivitetet dhe rolin e Kryqit të kuq në organizim të organizatës joqeveritare “Shoqatë për aktivizim rinor Kuantum”. Është realizuar prani në panairin për zhvillim të karrierës “Ekspo të karrierës” më (09.10.2013) të organizuar nga ana e Këshillit rinor të Ambasadës amerikane me qëllim promovim, diseminim dhe bashkëpunim.

FALËNDERIM PËR PARTNERËT DHE DONATORËT

- Federatën ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe;
- Komitetin ndërkombëtar të Kryqit të kuq;
- Kryqin e kuq të Gjermanisë;
- Kryqin e kuq në Baden Virtemberg;
- Gjysmëhënën e kuqe të Turqisë;
- Kryqin e kuq të Austrisë;
- Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës;
- Ambasadën e Francës;
- Ambasadën e Sllovenisë;
- Ministrinë për mbrojtje;
- Ministrinë për punë dhe politikë sociale;
- Ministrinë e shëndetësisë;
- Ministrinë e punëve të brendshme;
- Ministrinë e arsimit dhe shkencës;
- Qendrën për menaxhim me kriza;
- Drejtorinë për mbrojtje dhe shpëtim;
- Bashkësinë e njëjve të vetëqeverisjes lokale;
- Entin për mbrojtje sociale;
- SSMH – Zyra në Shkup
- Fondin global;
- UNHCR;
- EVN Maqedoni SHA;
- CIRA, Qendra për zhvillim institucional;
- OJQ Rubikon;
- OJQ Qendra vullnetare Shkup;
- HERA;
- Agjencinë të Austrisë për zhvillim
- Odën ekonomike të Maqedonisë;
- Lidhjen e odave ekonomike të Maqedonisë;
- Postën e Maqedonisë;
- Panairin e Shkupit ERA
- ONE;
- Operatorin VIP
- Fondacioni T-Mobile për Maqedoni;
- Banka Komerciale SHA Shkup;
- Alfa Banka SHA Shkup;
- Banka e Ohrit SHA Ohër – Societe Generale Group
- Stopanska banka SHA Shkup;
- Sigurimi SAVA SHA Shkup;
- OKTA SHA – Shkup;
- Studio Moderna;
- Korea Auto Trejd;
- Spitali special “Filipi i dytë”
- Adriamed
- ALKALOID SHA Shkup
- EVROPA 92

- Geneks
- Radio Televizioni i Maqedonisë;
- Televizioni SITEL
- Televizioni Kanal 5
- Televizioni ALSAT M;
- Televizioni ALFA
- Televizioni TELMA;
- Televizioni MTM;
- Agjencia informative e Maqedonisë – MIA
- Media Print Maqedoni
- VEÇER



RAPORT FINANCIAR PËR VITIN 2013

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë punën e vet e paraqet nëpërmjet raportit financiar i cili i përmban të hyrat dhe të dalurat e planifikuara dhe të realizuara. Raporti financiar paraqet vërtetim për aktivitetet e implementuara programore dhe projektuese me sukses të përkrahura nga partnerët vendas dhe të huaj të organizatës.

Puna e organizatës e paraqitur nëpërmjet të dhënave financiare paraqet një vit të mbaruar me sukses me realizimin e Buxhetit me 136.07% për dallim nga viti 2012 kur realizimi ishte 128.43%. Të hyrat personale janë realizuar me 129.66% dhe shënojnë rritje në krahasim me vitin 2012 kur realizimi ishte 114.60% dhe marrin pjesë me 29.30% nga të hyrat e përgjithshme të realizuara. Të hyrat nga organet dhe donatorët, paraqesin të hyra qëllimore, të cilat në pjesë të madhe drejtëpërsëdrejti transferohen në organizatat komunale, ku përdoren për implementimin e aktiviteteve projektuese. Këto të hyra janë realizuar me 138.92% shënojnë rritje në krahasim me vitin 2012 kur janë realizuar 131.26%. Të njëjtat marrin pjesë 70.70% nga të hyrat e përgjithshme të realizuara në vitin 2013.

Në pjesën e të dalurave mund të vërtetohet se shpenzimi është i kontrolluar dhe me qëllim që është bazë e secilës organizatë. Nga të dalurat e përgjithshme të realizuara, shpenzimet funksionale gjegjësisht programore shënojnë rritje në krahasim me vitin e kaluar dhe janë 71,73%, të dalurat për rrogat e të punësuarve janë 10,68%, ndërsa shpenzimet materiale janë 17,59%. Nga të dalurat e përgjithshme të realizuara, 26.77% kanë të bëjnë për nevojat e qendrës dhe shënojnë rënie në krahasim me vitin e kaluar, 38.99% drejtëpërsëdrejti janë transferuar në organizatat komunale të Kryqit të kuq dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit dhe të njëjtat shënojnë rritje në krahasim me vitin e kaluar, përderisa të tjerat 34.24% janë mjete të cilat janë shpenzuar në zyrën qendrore dhe që kanë të bëjnë për realizimin e aktiviteteve programore të organizatave komunale të KK dhe KK të qytetit të Shkupit.

Një pjesë e tepricës së mjeteve financiare gjegjësisht dallimi pozitiv mes të hyrave dhe të dalurave janë mjete qëllimore të cilat kanë të bëjnë me projekte realizimi i së cilëve vazhdon në vitin 2014.

Nga ana e Këshillit ekzekutiv të Kryqit të kuq të RM-së u informua komisioni, i cili bëri revizion të brendshëm në punën financiare dhe materiale. Gjithashtu u angazhua shtëpi e jashtme e pavarur për revizion, e cila bëri revizion në pajtueshmëri me Ligjin për revizion dhe Standardet ndërkombëtare për lamrëim financiar dhe

dispozitat kontabiliste të cilat vlejné në Republikën e Maqedonisë. Sipas mendimit të shtëpisë për revizion, gjendja financiare e organizatës së Kryqit të kuq të RM-së është paraqitur në mënyrë reale dhe objektive.

Raporti financiar ka të bëjë vetëm me punën e zyrës qendrore të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë.



RAPORT FINANCIAR

KRYQI I KUQ I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË 01.01.2013 - 31.12.2013

	Buxheti 2013	Realizuar në vitin 2013	%	% në 2012
TË HYRA TË PËRGJITHSHME	48,296,830.00	65,719,584.00	136.07	128.43
Burime personale të të hyrave	14,851,500.00	19,257,003.00	129.66	114.60
Të hyra nga organe / donatorë	33,445,330.00	46,462,581.00	138.92	131.26
TË DALURA TË PËRGJITHSHME	48,296,830.00	58,432,991.00	120.99	115.73
Rroga dhe kompensime për të punësuarit	6,340,000.00	6,240,127.00	98.42	93.76
Të dalura për materiale dhe shërbime	7,243,232.00	10,280,106.00	141.93	167.65
Të dalura funksionale (programore)	34,713,598.00	41,912,758.00	120.74	109.03
DALLIMI	0.00	7,286,593.00		

TË HYRA

PËRSHKRIM	Burime personale të të hyrave	Të hyra nga organe dhe donatorë	Buxheti 2013	Realizuar nga burime personale	Realizuar nga organe dhe donatorë	Realizuar në vitin 2013
TRANSFERE DHE DONACIONE						
Ministria e punës dhe politikës sociale	6,200,000.00		6,200,000.00	5,500,000.00		5,500,000.00
Dhurimi i gjakut (Ministria e shëndetësisë)		7,000,000.00	7,000,000.00		5,230,000.00	5,230,000.00
Veprimtari sociale - humanitare	300,000.00	2,000,000.00	2,300,000.00	206,880.00	5,131,105.00	5,337,985.00
Organizim dhe zhvillim		3,100,000.00	3,100,000.00	39,150.00		206,880.00
Ndihma e parë	2,350,000.00		2,350,000.00	2,372,167.00		2,372,167.00
Edukim shëndetësor		10,301,062.00	10,301,062.00		13,264,996.00	13,264,996.00
Rinia	110,000.00	140,000.00	250,000.00	171,000.00	31,857.00	202,857.00
Katastrofa		719,568.00	719,568.00	44,968.00	7,510,713.00	7,555,681.00
Diseminim		123,000.00	123,000.00			0.00
KK në aksion - PVH			0.00			0.00
Informim dhe komunikim			0.00			0.00
Shërbimi për kërkim		61,700.00	61,700.00			3,566,332.00
Njësia ndërkombëtare / bashkëpunim ndërkombëtar			0.00		3,566,332.00	0.00
Mobilizim i fondeve]	500,000.00		500,000.00			0.00
Financa (të hyra tjera)/kredit për veturë / ndalesa nga të punësuarit, kamata			0.00	92,147.00		92,147.00
TË HYRA PA TATIM						
Nga OKKK (në bazë të kotizimit)	1,500,000.00		1,500,000.00	420,462.00		420,462.00
Donacion nga personat fizik	300,000.00		300,000.00	4,000.00		4,000.00
Donacion nga persona juridik / Shitja e veturave	500,000.00		500,000.00			0.00
Pagesa shtesë për triska (nga ligji i KK)	300,000.00		300,000.00	228,006.00		228,006.00

Nga qirajamarrja për pjesën afariste / të hyra tjera	1,291,500.00		1,291,500.00	2,511,910.00		2,511,910.00
Nga regjistrimi i automjeteve	500,000.00	10,000,000.00	10,500,000.00	624,822.00	10,283,276.00	10,908,098.00
Të hyra tjera / të hyra nga kamata/ Fondi i solidaritetit / Fondi për zhvillim / PVH			0.00	1,642,317.00	804.00	1,643,121.00
Të hyra të transferuara nga viti i kaluar	1,000,000.00		1,000,000.00	5,399,174.00	1,443,498.00	6,842,672.00



TË HYRA TË PËRGJITHSHME	14,851,500.00	33,445,330.00	48,296,830.00	19,257,003.00	46,462,581.00	65,719,584.00
--------------------------------	----------------------	----------------------	----------------------	----------------------	----------------------	----------------------

TË DALURA



PËRSHKRIM	Nga burime personale	Bga organe dhe donatorë	Buxheti 2013	Realizuar nga burime personale	Realizuar nga organe dhe donatorë	Realizuar në vitin 2013
TË DALURA VIJUESE						
Rrogat bazë dhe kompensimet	5,673,104.00	616,896.00	6,290,000.00	5,227,454.00	908,612.00	6,136,066.00
Tatimi personal	50,000.00	0.00	50,000.00	78,412.00	25,649.00	104,061.00
TË DALURA TË PËRGJITHSHME PËR RROGA	5,723,104.00	616,896.00	6,340,000.00	5,305,866.00	934,261.00	6,240,127.00
Të dalura për rrugë dhe mëditje	100,000.00	0.00	100,000.00	166,290.00	226,443.00	392,733.00
Shërbime komunale	885,000.00	110,268.00	995,268.00	860,342.00	60,916.00	921,258.00
Nxemje	650,000.00	0.00	650,000.00	406,293.00	0.00	406,293.00
Komunikim dhe transport	1,310,000.00	382,335.00	1,692,335.00	1,312,383.00	958,057.00	2,270,440.00
Materiale	1,075,500.00	2,823,287.00	3,898,787.00	1,572,335.00	3,155,180.00	4,727,515.00
Mirëmbajtje të vazhdueshme	688,000.00	0.00	688,000.00	1,107,158.00	226,075.00	1,333,233.00
Shërbime me kontratë	4,704,232.00	8,698,511.00	13,402,743.00	4,604,404.00	5,918,137.00	10,522,541.00
Të dalura tjera operative	0.00	0.00	0.00	1,307,519.00	7,391,145.00	8,698,664.00
Transfere nga organizata joprofitabile	0.00	20,229,697.00	20,229,697.00	0.00	22,610,518.00	22,610,518.00
TË DALURA TË PËRGJITHSHME VIJUESE	9,412,732.00	32,244,098.00	41,656,830.00	11,336,724.00	40,546,471.00	51,883,195.00
TË DALURA KAPITALE						
Blerje të mobiljeve dhe pajisjeve për zyre	0.00	0.00	0.00	101,822.00	37,847.00	139,669.00
Blerje të automjeteve						
Mirëmbajtje të thjeshta dhe speciale	300,000.00	0.00	300,000.00	170,000.00	0.00	170,000.00
TË DALURA TË PËRGJITHSHME KAPITALE	300,000.00	0.00	300,000.00	271,822.00	37,847.00	309,669.00
TË DALURA TË PËRGJITHSHME	15,435,836.00	32,860,994.00	48,296,830.00	16,914,412.00	41,518,579.00	58,432,991.00

Shërbimi financiar	Sekretar gjeneral			
Zhaklina Popoviq	m-r Sait Saiti			%
	Transfere në OKKK		22,780,518.00	38.99
	Shpensime për qendrën		15,642,415.00	26.77
	Shpensime nga qendra për OKKK		20,010,058.00	34.24
	Të dalura		58,432,991.00	100.00


Të hyrat e përgjithshme të realizura në vitin 2013



Të dalura në vitin 2013



Struktura e të hyrave



RAPORT I REVIZORIT TË PAVARUR

Ne kryem revizion në raportet financiare të cilat u paraqitën nga "KRYQI I KUQ I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË" (në tekstin e mëtejme Organizatë), të cilët e kycin Bilancin e gjendjes më 31 dhjetor të vitit 2013, si dhe Bilancin e të hyrave dhe të dalurave dhe Raportin për ndryshime në fondin afarist për vitin i cili mbaron më atë ditë dhe shqyrtimin e politikave të rëndësishme kontabiliste dhe shënime tjera interpretuese.

Raportet financiare të paraqitura për vitin 2013 përbëhen nga raportet për punë të rregullt të Organizatës si dhe raportet për projektet: 1) Fushata për HIV/SIDA; 2) Forumi SEE për adaptim në ndryshime klimatike; 3) Fondi global për mbajtjen e prevalencës së ulët të HIV/SIDA në RM-së; 4) Federata ndërkombëtare e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe; 5) Kryqi i kuq i Spanjës; 6) Intervenca DOTS në RM-së; 7) Promovimi i vlerave humane; 8) Kryqi i kuq i Gjermanisë (9 projekte) dhe raportet për dy fondet: 1) Fondi për zhvillim dhe 2) Fondi i solidaritetit. Projektet janë financuar nga donatorë të posaçëm dhe të njëjtat realizohen nëpërmjet nënlogarive të posaçme (qëllimore) të Organizatës. Për ata Organizata nuk nuk përgatit raporte të posaçme financiare.

Përgjegjësia e menaxhmentit për raportet financiare

Menaxhmenti i Organizatës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin objektiv të këtyre raporteve financiare në pajtueshmëri me Ligjin për kontabilitet të organizatave joprofitabile dhe standardet për paraqitje financiare të bazës së gatshme. Kjo përgjegjësi kyc: formën, implementimin dhe mbajtjen e kontrollit intern që është relevant për përgatitjen dhe prezantimin objektiv të raporteve financiare të cilat janë të lira nga paraqitja e gabueshme materiale, pa dallim se a janë rezultat i mashtrimit apo gabimit, zgjedhje dhe zbatim të politikave adekuate kontabiliste, si dhe kryerja e vlerësimeve kontabiliste të cilat janë të kuptueshme në rrethana.

Përgjegjësia e revizorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim mendimin për këto raporte financiare në bazë të revizionit tonë. Revizionin e zbatuam në pajtueshmëri me Standardet ndërkombëtare për revizion. Ato standarde kërkojnë t'i respektojmë kërkesat etike dhe ta planifikojmë dhe kryejmë revizionin që të marrim besim të kuptueshëm për atë se a janë të lira nga raportet financiare nga paraqitja e gabueshme materiale.

Revizioni kyç zbatimin e procedurave për grumbullimin e dëshmimeve revizore për shumat dhe zbardhjet në raportet financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i revizorit, duke kycur edhe vlerësimin e rreziqeve nga paraqitja e gabueshme materiale të raporteve financiare, pa dallim se a janë rezultat i mashtrimit apo gabimit. Kur i kryen ato vlerësime të rrezikut, revizori e shqyrton kontrollimin intern relevant për përgatitjen dhe prezantimin objektiv të raporteve financiare që të formojë procedura revizore të cilat janë adekuate me rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së mendimit për efektivitetin e kontrollit intern. Revizioni gjithashtu kyc edhe notën e adekuatitetit të politikave të përdorura kotabiliste dhe të të kuptuarit të vlerësimeve kontabiliste të bëra nga ana e menaxhmentit, si dhe nota e prezantimit të përgjithshëm të raporteve financiare.

Ne besojmë se dëshmitë revizore të cilat i kemi grumbulluar janë të kapshme dhe adekuate që të sigurojnë bazë të mendimit tonë për revizion.

Mendimi i revizorit

Sipas mendimit tonë, raportet tona të paraqitura të "KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË" e paraqesin në mënyrë reale dhe objektive në të gjitha aspektet e rëndësishme, gjendjen financiare të organizatës më 31 dhjetor të vitit 2013, si dhe rezultatet e punës së vet dhe ndryshimet në fondet për vitet të cilat mbarojnë në këtë ditë, në pajtueshmëri me Ligjin për kontabilitet të organizatave kontabiliste dhe standardet për paraqitjen financiare të bazës së gatshme.

Raport për kërkesa tjera juridike dhe rregullative

Menaxhmenti i Organizatës gjithashtu është përgjegjës për përgatitjen e raportit financiar për punën në pajtueshmëri me Ligjin për shoqatat e qytetarëve dhe fondet.

Përgjegjësia jonë në pajtueshmëri me Ligjin për revizion është që të kumtojmë se a është konzistent raporti vjetor me llogarinë vjetore dhe me raportet financiare për vitin i cili mbaron më 31 Dhjetor të vitit 2013. Puna jonë në bazë të raportit vjetor për punë është kryer në pajtueshmëri me MCP 720 dhe është kufizuar në kumtime se a janë konzistente informacionet historike financiare të paraqitura në raportin vjetor për punën me llogarinë vjetore dhe raportet e reviduara financiare.

Raporti vjetor për punë është konzistent, nga të gjitha aspektet materiale, me llogarinë vjetore dhe raportet e reviduara financiare të "KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË"; Shkup për vitin i cili mbaron më 31 dhjetor të vitit 2013.

Shkup, 03 mars 2014

Drejtues
Dragan Dimitrov



Revizor i autorizuar
Zvonko Kočovski





www.redcross.org.mk

 www.facebook.com/CrvenKrstNaRepublikaMakedonija

 www.youtube.com/MacedonianRedCross